



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE NË FUSHËN E DREJTËSISË

# STRATEGJIA NDËRSEKTORALE E DREJTËSISË 2021-2025

## RAPORTI I MONITORIMIT 2022

### JUSTAL

Technical Assistance to Support  
the Implementation of the Cross  
Justice Strategy in Albania



Funded by  
the European Union



Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë 2021 – 2025 është vazhdimi i rrugëtimit të përbashkët, të filluar në vitin 2014, për transformimin e sistemit të drejtësisë në një sistem drejtësie të pavarur, paanshëm dhe profesional, që në thelb ka si qëllim të mbrojtë interesat e çdo qytetari shqiptar, me të njëjtën cilësi, sikurse mbrohen edhe interesat e çdo qytetari të Bashkimit Evropian. Ky dokument është shprehje e vullnetit të palëkundur të Qeverisë shqiptare që reformimi i sistemit të drejtësisë është rruga e duhur për jetësimin e ëndrrës së kahershme të qytetarëve shqiptarë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

**Ulsi Manja**  
Ministër i Drejtësisë

# STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË

## RAPORTI I MONITORIMIT 2022

### TABELA PËRMBLEDHËSE

<b>I. INFORMACION PËRMBLEDHËS</b> .....	7
1.1. Përmbledhja Ekzekutive.....	7
1.2. Metodologjia .....	11
<b>II. PROGRESI I STRATEGJISË</b> .....	17
2.1 Reforma të zbatuara me sukses në 2022 .....	17
2.2 Impakti i zbatimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritit evropian	20
2.3 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit .....	21
<b>III. PROGRESI LIDHUR ME QËLLIMET E POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË &amp; MASAT</b> .....	23
3.1 Përmbledhje e arritjeve në lidhje me Qëllimet e Politikave dhe Objektivat Specifikë sipas masave.....	23
3.2 Vlerësimi i arritjes së Qëllimeve të Politikës kundrejt masave dhe treguesve .....	26
3.2.1 Qëllimi i Parë i Politikës .....	27
Objektivi Specifik 1.1. ....	27
Objektivi Specifik 1.2. ....	30
Objektivi Specifik 1.3. ....	35
3.2.2 Qëllimi i Dytë i Politikës .....	39
Objektivi Specifik 2.1. ....	41
Objektivi Specifik 2.2. ....	45
Objektivi Specifik 2.3. ....	47
Objektivi Specifik 2.4. ....	52
Objektivi Specifik 2.5. ....	57
3.2.3 Qëllimi i Tretë i Politikës.....	63
Objektivi Specifik 3.1. ....	64
Objektivi Specifik 3.2. ....	67
Objektivi Specifik 3.4. ....	72
Objektivi Specifik 3.5 .....	77
3.2.4 Qëllimi i Katërt i Politikës .....	82
Objektivi Specifik 4.1. ....	83
Objektivi Specifik 4.2. ....	87

Objektivi Specifik 4.3. ....	89
Objektivi Specifik 4.4. ....	92
<b>IV. RISKU DHE HAPAT NË VIJIM.....</b>	<b>95</b>
4.1 Pasqyrë e Përgjithshme .....	95
4.2 Vlerësimi i riskut.....	96
4.2.1 Qëllimi i Parë i Politikës .....	96
4.2.2 Qëllimi i Dytë i Politikës .....	97
4.2.3 Qëllimi i Tretë i Politikës.....	98
4.2.4 Qëllimi i Katërt i Politikës .....	99
4.2 Hapat vijues.....	100

<b>AT</b>	<i>Asistencë Teknike</i>
<b>BE</b>	<i>Bashkimi Evropian</i>
<b>BKH</b>	<i>Byroja Kombëtare e Hetimit</i>
<b>CAMS</b>	<i>Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve të Shërbimit të Prokurorisë Shqiptare</i>
<b>DNJF</b>	<i>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas</i>
<b>DHASH</b>	<i>Dhoma Kombëtare e Avokatisë e Shqipërisë</i>
<b>DHKN</b>	<i>Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësuesve</i>
<b>DHKPGJP</b>	<i>Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë</i>
<b>DPB</b>	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</i>
<b>DPKHL</b>	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit</i>
<b>DPPP</b>	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave</i>
<b>DPSHP</b>	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës</i>
<b>DSIK</b>	<i>Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar</i>
<b>GJEDNJ</b>	<i>Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut</i>
<b>GJK</b>	<i>Gjykata Kushtetuese</i>
<b>GJL</b>	<i>Gjykata e Lartë</i>
<b>GP</b>	<i>Grup Pune</i>
<b>IEVP</b>	<i>Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale</i>
<b>ILD</b>	<i>Inspektori i Lartë i Drejtësisë</i>
<b>IPA</b>	<i>Instrumenti i Asistencës Para-Anëtarësimit</i>
<b>IPSI</b>	<i>Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar</i>
<b>IT</b>	<i>Teknologjia e Informacionit</i>
<b>JFA</b>	<i>Projekti "Justice for All"</i>

**LISTA E AKRONIMEVE**

<b>KE</b>	<i>Këshilli i Evropës</i>
<b>KEDNJ</b>	<i>Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut</i>
<b>KLJG</b>	<i>Këshilli i Lartë Gjyqësor</i>
<b>KLP</b>	<i>Këshilli i Lartë i Prokurorisë</i>
<b>KM</b>	<i>Këshilli i Ministriave</i>
<b>KPA</b>	<i>Kolegji i Pavarur i Kualifikimit</i>
<b>KPK</b>	<i>Komisioni i Pavarur i Kualifikimit</i>
<b>NJKV</b>	<i>Njësitë e Kujdesit të Veçantë</i>
<b>MD</b>	<i>Ministria e Drejtësisë</i>
<b>MFE</b>	<i>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</i>
<b>MShMS</b>	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>
<b>OJF</b>	<i>Organizata Joqeveritare</i>
<b>OS</b>	<i>Objektiv Specifik</i>
<b>OSFA</b>	<i>Fondacioni “Shoqëria e hapur për Shqipërinë”</i>
<b>OZHQ</b>	<i>Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm</i>
<b>PKIE</b>	<i>Plani Kombëtar për Integrimin Evropian</i>
<b>PP</b>	<i>Prokuroria e Përgjithshme</i>
<b>PSDHS</b>	<i>Plani Strategjik i të Dhënave Sistemike</i>
<b>PZ</b>	<i>Periudha e Zbatimit</i>
<b>QP</b>	<i>Qëllim Politike</i>
<b>QTI</b>	<i>Qendra e Teknologjisë dhe Informacionit</i>
<b>SASPAC</b>	<i>Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës</i>
<b>SHM</b>	<i>Shkolla e Magjistraturës</i>

<b>SKZHI</b>	<i>Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim</i>
--------------	---

<b>SND</b>	<i>Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë</i>
------------	--

<b>SPAK</b>	<i>Struktura e Posaçme Antikorrupsion</i>
-------------	---

<b>TF</b>	<i>Task Forca</i>
-----------	-------------------

# I. INFORMACION PËRMBLEDHËS

## 1.1. Përmbledhja Ekzekutive

Reforma në Drejtësi, e konsideruar vitet e fundit si një proces prioritar për shtetin shqiptar, u iniciua me synimin që sistemi i drejtësisë të ndryshonte thelbësisht për të garantuar dhe konsoliduar pavarësinë, efikasitetin, rritjen e transparencës, forcimin e besimit të publikut si dhe përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës së sistemit penitenciar. Jetësimi me sukses i Reformës në Drejtësi kërkon vëmendje lidhur me përgjegjësitë institucionale të secilit institucion të përfshirë me qëllim konsolidimin e rezultateve.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025 dhe dokumentet e saj strategjike si, Plani i Veprimt dhe Pasaporta e Indikatorëve, u miratuan në vitin 2021 me VKM nr. 823, datë 24.12.2021 dhe zbatimi i saj nisi menjëherë. Raporti Vjetor i parë mbi zbatimin e SND në vitin 2021 u miratua në vitin 2022 me Vendimin nr. 5, datë 31.03.2022 të Komitetit Drejtues Sektorial. Në vijim Komiteti Drejtues Sektorial me vendimin nr. 36, datë 19.12.2022, ka miratuar edhe raportin për periudhën janar-qershor 2022 me vendimin nr.

Në këtë raport analizohet ecuria e zbatimit të SND për vitin 2022. Raporti përmbledh të dhëna dhe analiza të mbledhura nga 18 institucione në sektorin e drejtësisë. Të gjitha institucionet e pavarura të drejtësisë dhe disa institucione nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë kanë kontribuar në zbatimin e SND.

Në mënyrë të përmbledhur, viti 2022 ka shënuar disa arritje të rëndësishme, pozitive dhe inkurajuese në fushat kryesore të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë të cilat janë përkthyer në rezultate konkrete dhe kanë pasur impakt në disa drejtime kryesore në lidhje me katër Qëllimet e Politikave të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Shqipëria aplikoi për anëtarësim në Bashkimin Evropian në prill të vitit 2009 dhe mori statusin e vendit kandidat në qershor të vitit 2014. Më 24 mars 2020 ministrat e çështjeve evropiane dhanë pëlqimin e tyre politik për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Më 19 korrik 2022 në Bruksel, u mbajt Konferenca e Parë Ndërqeveritare midis Shqipërisë dhe BE-së, një moment historik i rrugëtimit të integritimit evropian të Shqipërisë dhe një hap më afër në realizimin e aspiratës së popullit shqiptar për të qenë pjesë e familjes evropiane. SND 2021-2025 synon të reflektojë standardet e parashikuara në Kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”. Vizioni i SND 2021-2025 dhe qëllimet e politikës synojnë drejtpërdrejt rritjen e kapaciteteve institucionale për të udhëhequr procesin e përafrimit të legjislacionit me *acquis* e BE-së për këtë kapitull. Zbatimi në mënyrën e duhur i *acquis* në sistemin vendas përbën një ndër kushtet themelore për integritimin evropian të vendit.

*“[Shqipëria] ka bërë përparim të mirë, veçanërisht përmes zbatimit të vazhdueshëm dhe konsolidimit të reformës gjithëpërfshirëse në drejtësi.”*

Raporti i Komisionit Evropian, 12 Tetor 2022


SND 2021-2025 parashikon për zbatim gjatë 5 viteve të implementimit të saj 17 Objektiva Specifikë dhe 184 masa. Në analizë, për periudhën raportuese janë marrë në konsideratë:




- 16 OS; pasi OS që lidhet me Drejtësinë për të Mitur, gjen zbatim në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026;
- 169 masa të cilat janë përcaktuar për tu zbatuar nga institucionet gjatë viteve 2021-2022.

Raporti paraqet gjithashtu një analizë të thellë mbi zbatimin të 32 indikatorëve të parashikuar në Pasaportën e Indikatorëve, lidhur me secilin Qëllim Politik dhe Objektiv Specifik (shih Kapitulli III). Gjetjet kryesore të këtij raporti paraqiten në mënyrë grafike si më poshtë.


## 16 OBJEKTIVA SPECIFIKË DHE 169 MASA TË ZBATUESHME GJATË PERIUDHËS 2021-2022



Masat e realizuara plotësisht dhe pjesërisht në vitin 2022



Objektivat Specifikë të realizuar plotësisht dhe pjesërisht në vitin 2022



Objektivat Specifikë që kanë shënuar progres në periudhën 2021-2022

## REALIZIMI I QËLLIMEVE TË POLITIKËS NË VITIN 2022




**QËLLIMI I I POLITIKËS**  
Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes



**QËLLIMI II I POLITIKËS**  
Rritja e transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi




**QËLLIMI III I POLITIKËS**  
Një sistem i drejtësisë penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë




**QËLLIMI IV I POLITIKËS**  
Kordinimi dhe menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë

**Në vitin e dytë të zbatimit të SND, të katërt Qëllimet e Politikës janë realizuar tashmë mbi 50%**


## Progres në vitin 2022 për të katër Qëllimet e Politikës.




Niveli i Realizimit:  
Qëllimi Politik I



Niveli i Realizimit:  
Qëllimi Politik II



Niveli i Realizimit:  
Qëllimi Politik III




Niveli i Realizimit:  
Qëllimi Politik III

Situata aktuale në Qëllimin e Katërt të Politikës kërkon përpjekje të vazhdueshme në koordinim për zhvillimin e plotë të sistemit të integruar të drejtësisë elektronike dhe sistemeve të komunikimit përmes metodologjisë IPSIS.



## DISA NGA ARRITJET DHE SFIDAT KRYESORE



Në vijim, për të mundësuar përmirësimin e performancës nga institucionet, dhe një raportim domethenës i cili përmban elemente për identifikimin në kohë të risqeve dhe adresimin efikas të tyre, SND dhe dokumentat e saj strategjike duhet të përditësohen. Ky përditësim do të reflektojë situatën aktuale të sistemit dhe institucioneve, si edhe nevojat dhe prioritetet e institucioneve në kuadër të procesit të integritimit në BE.

## ***1.2. Metodologjia***

Metodologjia e Raportit të Monitorimit, përshkruan procesin e ndjekur gjatë hartimit të raportit dhe ka si qëllim kryesor të mundësojë udhëzimet e nevojshme për lehtësimin në kuptueshmërinë e tij, si dhe të orientohet drejt prezantimit të rezultateve kryesore për të nxjerrë në pah arritjet, sfidat dhe rekomandimet e adresuara për përmirësim.

Për të siguruar një proces monitorimi bazuar në arritje konkrete, Ministria e Drejtësisë realizon komunikime intensive me përfaqësuesit e strukturave të përfshira në Planin e Veprimit, me qëllim prezantimin e drejtë dhe të qartë të rezultateve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës së raportimit.

Kështu, gjatë periudhës hartuese, është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm (verbal dhe zyrtar) në varësi të specifikave për plotësimin e dokumentave raportues me disa prej institucioneve të përfshira në strategji, me qëllim evidentimin e rasteve të suksesit, të cilat kanë sjellë rezultate të dukshme në veprimtarinë e tyre, gjithashtu identifikimin e sfidave, problematikave dhe komponentëve të cilët kanë ndikuar apo penguar progresin apo zbatimin e aktiviteteve të parashikuara.

### **— Koordinimi institucional për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 128, dt. 08.11.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues si dhe hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive. Ky sektor kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SND 2021-2025) për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2022, është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe kontributore të planit të veprimit.

### **— Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Ministria e Drejtësisë, harton raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SND-së për 5 vitet e ardhshme, raporte të cilat publikohen në linkun: <https://drejtesia.gov.al/plani-i-veprimit-te-strategjise-ndersektoriale-te-drejtesise/>

### **— Manuali i Raportimit sipas sistemit IPSIS**

Ministria e Drejtësisë ka hartuar raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS miratuar me vendimin nr.290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS).

## —Përputhshmëria e raporteve të monitorimit dhe performancës me Parimet e Mirëqeverisjes

Ky raport është hartuar përputhje me Parimet e Mirëqeverisjes të cilët përmbajnë një kornizë të vlerësimit të Raporteve të Monitorimit dhe të Performancës e cila mundëson analizën e rregullt të progresit të arritur në zbatimin e Parimeve dhe caktimin e standardeve që duhet të përmbush vendi. Parimet janë të hartuara për vendet që duan të anëtarësohen në BE dhe që marrin ndihmë nga BE-ja përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA).

- **Efikasiteti:** Agregimi i niveleve të dokumenteve. Ky parim duhet të lejojë shfrytëzimin e sinergjive mes raporteve të dokumenteve të ndryshme. Nëse dokumentet janë të lidhura ngushtë në aspektin e përmbajtjes, atëherë sistemi i M & R-së duhet ta marrë këtë parasysht për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të njëri-tjetrit dhe jo mbivendosjen e njëri-tjetrit. Elementet bazë të raporteve të M & R-së (p.sh. objektivat, masat, indikatorët) në dokumentin e nivelit më të ulët do të zhvillohen drejt përmbajtjes së M & R-së në dokumentet e nivelit në të lartë. Duhet të merren parasysht lidhjet. Ky parim duhet të përmirësojë frekuencën dhe përmbajtjen e raporteve të M & R-së.
- **Llogaridhënia:** Respektimi i përmbajtjes së dokumenteve të planifikimit. Raportet e monitorimit duhet të përqendrohen në elementet e dokumenteve të planifikimit për të siguruar llogaridhënie lidhur me reformat dhe ndërhyrjet e planifikuara.
- **Rëndësia:** Respektimi i nevojave të përdoruesve të monitorimit dhe performancës. Raportet e M & R-së duhet të jenë të përshtatura për nevojat e përdoruesit në aspektin e përmbajtjes, gjatësisë dhe frekuencës. Për më tepër, raportet duhet të japin llogari për arritjen e rezultateve në mënyrë të verifikueshme dhe në raport me treguesit SMART.

## —Mekanizimi i Integruar i Politikave

Komiteti Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi operon në nivel teknik përmes dy grupeve tematike, të cilat janë pjesë e grupit për menaxhimin e integruar të politikave për sektorin e drejtësisë dhe institucionet e tjera pjesëmarrëse, si dhe nëpërmjet sekretariatit teknik, rolin e të cilit e luan Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave në Ministrinë e Drejtësisë. Grupet tematike janë në përputhje dhe në zbatim të urdhrin të Kryeministrit nr.157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale / ndërsektoriale dhe krijimin e funksionimit të një mekanizmi të integruar sektorial / ndërsektorial”.

- Grupi tematik për funksionimin e plotë të sistemit të drejtësisë dhe aksesin në drejtësi.
- Grupi tematik për drejtësinë penale.

Në mbledhjen e grupeve tematike e zhvilluar në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë, në datën 13.04.2023 u diskutua raporti, problematikat dhe pengesat që dalin gjatë zbatimit të SND-së dhe ushtrimit normal të aktiviteteve të institucioneve përkatëse, si dhe hapat që do të ndiqen për realizueshmërinë e tyre.

## —Fazat e ndjekura për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Fazat që janë ndjekur për përgatitjen dhe konsolidimin e raportimit të monitorimit dhe performancës, paraqiten si më poshtë:

- kërkesa për kontribut u dërgua në datë 9 janar 2023 tek të gjitha institucionet raportuese në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes;
- organizimi i workshop nga asistenca JUSTAL:
- workshopi i parë i organizuar nga asistenca JUSTAL dhe MD në datë 25 Janar 2023, mbi forcimin e bashkëpunimit ndërmjet MD dhe institucioneve raportuese në SND.
- workshopi i dytë i organizuar më datë 3 Mars 2023, mbi problematikat e hasura gjatë zbatimit të masave nga institucionet.
- tryezë e rrumbullakët në datën 13 prill 2023 me Grupet Tematike mbi konsultimin e draftit të Parë të Monitorimit të SND për vitin 2022;
- publikimi në faqen zyrtare të internetin të Ministrisë së Drejtësisë dhe dërgimi tek të gjitha institucionet e përfshira në strategji me qëllim marrjen e komenteve dhe sugjerimeve;
- konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella;
- organizimi i mbledhjes së Komitetit Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi me qëllim miratimi i raportit të monitorimit;
- publikimi i Raportit Vjetor të Monitorimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë;
- dërgimi i procedurave të mbledhjes të KDS-së (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) dhe paketa finale, së bashku me linkun e publikimit për njohje SASPAC.

#### — Metodologjia e analizimit të të dhënave për Raportin e Monitorimit dhe Performancës

- Raporti shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur grafikë, dashboards, analiza të thelluara, edhe vizualisht përmes tabelave. Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës për Qëllimet e Politikave dhe Objektivët Specifikë.
- Analiza mbi progresin e realizimit të Qëllimeve Politike ndjek një qasje të strukturuar. Progresi lidhur me secilin Qëllim Politik është analizuar në përgjithësi sipas Objektivave Specifikë (OS) përkatës. Në vijim, për secilin OS është paraqitur një përmbledhje e rezultateve sasiore dhe cilësore të zbatimit të masave përkundrejt kryerjes së veprimeve për realizimin e tyre nga institucionet përgjegjëse, analiza e risqeve dhe veprimeve për adresimin e tyre (sipas rastit) dhe analiza e treguesve të performancës, nëse kjo ka qënë e mundur mbi bazën e të dhënave të paraqitura nga institucionet përgjegjëse.

Prezantimi i rezultateve mbi zbatimin a masave ndjek numërimin e Planit të Veprimit dhe është prezantuar me sfond me ngjyrë sipas nivelit të zbatimit (*të zbatuara plotësisht/ të zbatuara pjesërisht/ të pazbatuara*). Masat të cilat fillojnë periudhën e zbatueshmerisë pas vitit 2022 janë shënuar me sfond të bardhë.

Analiza mbi progresin e realizimit të OS sipas masave dhe treguesve të performancës përkatës, përfshin edhe një tabelë përmbledhëse të gjetjeve kryesore në lidhje me arritjet, risqet dhe sfidat.

- Analiza për vitin 2022 përmban edhe elemente krahasueshmërie me vitin 2021, për të evidentuar zhvillime në lidhje me realizimin e Qëllimeve të Politikës, Objektivave Specifikë, masave dhe treguesve të performancës.

- **Përcaktimi i nivelit të zbatimit të masave** (në përqindje) është ai i raportuar nga secili institucion përgjegjës, dhe është evidentuar në kontributet e përcjella prej tyre mbi çdo masë të përcaktuar (Aneksi 1). Gjithashtu, shkalla e zbatimit të masave është përcaktuar në bazë të intervalit:
  - **E zbatuar**: masa e cila është përmbushur në vlerën 100%;
  - **Pjesërisht e zbatuar/Në proces**: masa e cila në periudhën e raportimit ka pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijon të jetë në zbatueshmëri në vlerën 50%-99%.
  - **E pazbatuar**: masa e cila nuk ka pasur zhvillim dhe progres për periudhën raportuese (vlera e raportuar 0%-49%).

- **Përcaktimi i nivelit të realizimit të treguesve të performancës** është përlllogaritur përkundrejt targetit të vendosur për vitin 2022 në Pasaportën e Treguesve.

Në rastin e *treguesve me trend në rritje* (si p.sh. numri i akteve nënligjore të miratuara nga një institucion) ku synohet që vlera e raportuar të jetë e barabartë ose më e lartë se targeti, niveli i realizimit të targetit është përlllogaritur si raporti midis vlerës së raportuar (R) dhe targetit (T), e shprehur në përqindje ( $R/T * 100\%$ ).<sup>1</sup>

Në rastin e *treguesve me trend në zbritje* (si p.sh. kohëzgjatja mesatare e çështjeve penale në apel) ku vlera më të ulëta se targeti konsiderohen arritje pozitive, niveli i realizimit të targetit është përlllogaritur si raporti midis targetit (T) dhe vlerës së raportuar (R), e shprehur në përqindje ( $T/R * 100\%$ ).<sup>2</sup>

Kur vlera e raportuar është zero (0), edhe përqindja e realizimit të targetit është konsideruar zero (0).

- **Përcaktimi i nivelit të realizimit të OS** është përlllogaritur në dy mënyra.

*Së pari*, është analizuar realizimi i Objektivit Specifik si mesatarja e përqindjes së zbatimit të masave përkatëse. Analiza në nivelin e mesatares së përqindjes së zbatimit të masave pasqyron në mënyrë më të drejtpërdrejtë arritjet lidhur me Objektivat Specifikë në vitin 2022, në krahasim me analizën mbi treguesit. Të dhënat e disponueshme mbi treguesit e performancës – mungesa e tyre në disa raste – nuk mundësojnë një analizë të përgjithshme të harmonizuar për të gjithë OS. Shkalla e realizimit të OS është përcaktuar në bazë të intervalit:

- **I zbatuar**: mesatarja e përqindjes së zbatimit të masave në vlerën 100%;
- **Pjesërisht i zbatuar**: mesatarja e përqindjes së zbatimit të masave në vlerën 50%-99%.
- **I pazbatuar**: mesatarja e përqindjes së zbatimit të masave në vlerën 0%-49%.

*Së dyti*, është analizuar realizimi i Objektivit Specifik përkundrejt numrit të masave të zbatuara (e shprehur në %). Përlllogaritja është kryer në bazë të intervaleve të sistemit të performancës si në tabelën më poshtë:

<sup>1</sup> P.sh. nëse targeti është “5 akte” (T=5) dhe vlera e raportuar është “8 akte” (R=8), përqindja e realizimit të targetit llogaritet si  $(R)/T * 100 = 160\%$ . Nëse vlera e raportuar do të ishte “3 akte”, përqindja e realizimit të targetit do të ishte  $(R)/T * 100 = 60\%$ .

<sup>2</sup> P.sh. nëse targeti është “kohëzgjatja mesatare e çështjeve penale 3 muaj” (T=3) dhe vlera e raportuar është “2 muaj” (R=2), duke qënë ky një target me trend zbritës, vlera e raportuar tregon një performancë më të mirë të gjykatave sesa ajo e përcaktuar nga targeti. Përqindja e realizimit të targetit llogaritet si  $T/R * 100 = 150\%$ . Nëse vlera e raportuar do të ishte “5 muaj”, përqindja e realizimit të targetit do të ishte  $T/R * 100 = 60\%$ .

Kategoria	Niveli i Tolerancës
<b>Dobët</b>	Nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara
<b>Mjaftueshëm</b>	Nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara
<b>Mirë</b>	Nga 51 në 85 për qind e masave të realizuara
<b>Shumë mirë</b>	Nga 86 në 110 për qind e masave të realizuara
<b>Tejkaluar</b>	111 dhe më lart

- **Përcaktimi i nivelit të realizimit të Qëllimeve të Politikave** është përlogaritur si mesatarja e përqindjes së realizimit të Objektivave Specifikë përkatës.
- Në raportin e monitorimit vlerësohet **identifikimi i risqeve** me qëllim identifikimin e hapave që do të duhen të ndiqen për tu adresuar në kuadër të implementimit të objektivëve të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. Risqet janë identifikuar në nivel QP dhe OS në zbatim të Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.<sup>3</sup> Janë marrë në konsiderate dy aspekte: mundësia e verifikimit të risqeve dhe ndikimi i tyre, sipas vlerësimit të kryer nga secili institucion përgjegjës për zbatim. Secili nga këto dy aspekte vlerësohet në bazë të tre kategorizimeve: *i. ulët; ii. mesëm dhe iii. lartë.*
- Konkluzionet dhe rekomandimet janë të bazuara në përputhje me evidencat e raportit dhe japin masa konkrete për korrigjim/përmirësim për tu adresuar në vendimmarrje.

### — Analizat financiare

- Analiza e buxhetit të përdorur është analizuar e lidhur me programet buxhetore (identifikohet saktë numri total i programeve buxhetore) në tre (3) nivele: (i) qëllimi i politikave (ii) objektivi specifik.
- Shkalla e analizës financiare është kryer ku janë identifikuar dhe shkaqet e mungesës së fondeve dhe se si ky hendek do të trajtohet në të ardhmen.

### — Konsultimi publik i Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Një komponent i rëndësishëm i mirëqeverisjes që ndërlidhet me rritjen e cilësisë së llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike si dhe forcimin e demokracisë është procesi i konsultimit publik. Tashmë korniza rregullatore për konsultimin publik është unifikuar dhe ka ndikuar në përmirësimin e transparencës dhe cilësisë së politikave. Prioritare mbetet përfshirja aktive e publikut dhe shoqërisë civile në proceset e politikëbërjes.

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë e dërgoi në datën 11.05.2023 dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe e publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit [www.drejtesia.gov.al](http://www.drejtesia.gov.al), në menu prioritete/strategjia ndërsektoriale/Strategjia

<sup>3</sup> Analiza dhe vlerësimi i riskut është kryer referuar Guidës Metodologjike për hartimin e raporteve të monitorimit për Agjendën e Mirëqeverisjes.



Ndërsektorale e Drejtësisë. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e një takimi të dedikuar, në kuadër të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimit të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit.

Pas miratimit të raportit në Komitet Drejtues Sektorial, Ministria e Drejtësisë publikon në faqen e tij zyrtare raportin në gjuhën Shqipe dhe Angleze.

## II. PROGRESI I STRATEGJISË

### 2.1 Reforma të zbatuara me sukses në 2022

Reforma në Drejtësi, e konsideruar vitet e fundit si një proces prioritar për shtetin shqiptar, u iniciua me synimin që sistemi i drejtësisë të ndryshonte thelbësisht për të garantuar dhe konsoliduar pavarësinë, efikasitetin, rritjen e transparencës, forcimin e besimit të publikut si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës së sistemit penitenciar. Jetësimi me sukses i Reformës në Drejtësi kërkon vëmendje të shtuar gjithashtu edhe mbi përgjegjësitë që burojnë për institucionet e përfshira.

Në mënyrë të përmbledhur, viti 2022 ka shënuar disa arritje të rëndësishme, pozitive dhe inkurajuese në fushat kryesore të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë të cilat janë përkthyer në rezultate konkrete dhe kanë pasur impakt në disa drejtime kryesore në lidhje me katër Qëllimet e Politikave të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

#### Qëllimi i Parë i Politikës

**Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, eficientë dhe llogaridhëniën.**

Për përmbushjen me sukses të këtij qëllimi politik janë arritur rezultatet e mëposhtme:

- Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka ecur me ritme të rregullta në vitin 2022. KPK arriti të përfundojë vlerësimin e 75% subjekteve që i nënshtrohen vettingut, duke përmbushur kështu objektivin e vendosur në pasaportën e treguesve për vitin 2022. Ndryshimet Kushtetuese në lidhje me zgjatjen e mandatit të organeve të rivlerësimit (deri në dhjetor 2024) kanë dhënë garancitë e nevojshme për t'u mundësuar atyre përfundimin e të gjithë procesit në mënyrë efektive dhe në kohë.
- KLGJ, KLP dhe ILD kanë përgatitur analiza në lidhje me kuadrin ligjor të institucioneve të tyre dhe kanë sugjeruar ndryshimet e nevojshme në lidhje me Ligjin për Statusin, Ligjin për Qeverisjen si dhe të ligjeve të tjera përkatëse.
- ILD ka nxjerrë një numër të konsiderueshëm urdhrash dhe aktesh administrative që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e brendshëm e ILD për të garantuar cilësinë dhe efikasitetin e veprimtarive të kryera dhe të shërbimeve të ofruara.
- ILD ka kryer 3 inspektime tematike në bazë të Metodologjisë së miratuar. Dy prej tyre kanë përfunduar dhe raportet përkatëse i janë dërguar institucioneve përkatëse për zbatimin e rekomandimeve..
- 23 gjyqtarë dhe 22 prokurorë të rinj janë emëruar nga KLGJ dhe KLP në vitin 2022, pas diplomimit nga SHM.
- KLGJ ka ngritur në detyrë gjashtë (6) gjyqtarë në GJL dhe 11 gjyqtarë në gjykatat e Apelit. (7 ngritje në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, 1 në Gjykatën e Apelit Administrativ, 3 në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar) si edhe 1 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

## Qëllimi i Dytë i Politikës

### Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane.

Për përmbushjen me sukses të këtij qëllimi politik janë arritur rezultatet e mëposhtme:

- Falë plotësimit të vendeve vakante në GJL gjatë vitit 2022 (është arritur kuota 15 gjyqtarë, nga 19 të parashikuar në ligj) dhe miratimit të disa masave për reduktimin e backlog, GJL ka nisur një trend pozitiv të reduktimit gradual të backlog dhe të uljes së *disposition time* të çështjeve.
- Gjykata Kushtetuese është funksionale. Në bazë të propozimeve të KED, gjatë vitit raportues u plotësuan edhe tre vende vakante të tjera në GJK. Kryetari i GJK është zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve të GJK. Miratimi i Kodit të Etikës për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese shënon një tjetër arritje të këtij viti. Infrastruktura dhe logjistika e Gjykatës Kushtetuese lehtësojnë punën e përditshme të gjyqtarëve dhe personelit mbështetës.
- GJK arriti të reduktojë me sukses volumin e çështjeve në pritje, duke arritur dhe tejkaluar objektivin e vitit 2025 në Pasaportën e Treguesve që në vitin 2022.
- Shkolla e Magjistraturës ofroi formim fillestar në auditore për 163 kandidatë për magjistratë dhe 4 kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë në vit të parë, të dytë dhe të tretë të Programit të Formimit Fillestar dhe diplomoi 46 kandidatë. Ajo realizoi 81 aktivitete trajnuese me magjistratë të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor dhe nëpunës civilë gjyqësor, bazuar në një metodologji të riparë si për vlerësimin e nevojave për trajnim, edhe për cilësinë e trajnimit dhe efikasitetin e tij. SHM ka krijuar gjithashtu një bazë të dhënash të lektorëve dhe trajnerëve me ekspertizë në të drejtën e BE-së, të cilët janë angazhuar të trajtojnë ligjin e BE në kurrikulën e formimit fillestar dhe vazhdues dhe lidhjen e tij me ligjin shqiptar. Me qëllim adresimin e nevojave të menjëhershme të sistemit të drejtësisë duke garantuar edhe aksesin në drejtësi për qytetarët, Harta e Re Gjyqësore u miratua VKM nr. 495, datë 21.07.2022, "Mbi riorganizimin e rrethve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave". Harta gjyqësore e reformuar përfshin, ndër të tjera, 13 gjykata të shkallës së parë dhe një (1) gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm, dhe 2 gjykata administrative të shkallës së parë dhe 1 gjykatë administrative apeli dhe përcakton kompetencat e tyre territoriale përkatëse.
- KLGJ miratoi Planin e Komunikimit për Gjykatat në Nëntor 2022 dhe ka nisur zbatimin e tij.
- ILD ka vendosur një procedurë për komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët e cila tashmë ka rezultate shumë të mira. Nisma siguron qasje të lehtë në drejtësi dhe transparencë .
- Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka arritur rezultate të shkëlqyera në vitin 2022 dhe ka zbatuar të gjitha masat përkatëse të Planit të Veprimit. Gjithashtu, ka tejkaluar shumë vlerat e synuara në Pasaportën e Treguesve për ndihmën juridike falas, parësore dhe dytësore. Gjithashtu janë organizuar me sukses me mbështetjen e programeve të donatorëve, disa trajnime, të listuara në planin e veprimit.
- Është miratuar statuti i ri i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësuesve. Në vitin 2022 janë dhënë 247 licenca. Gjithashtu, 89 kandidatë janë trajnuar për t'u licencuar përmes provimit

në MD. 27 ndërmjetës janë trajnuar për trajnim të vazhdueshëm, i cili është i detyrueshëm.

### **Qëllimi i Tretë i Politikës**

**Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit.**

Për përmbushjen me sukses të këtij qëllimi politik janë arritur rezultatet e mëposhtme:

- Në vitin 2022 janë trajnuar dhe emëruar 21 oficerë të policisë gjyqësore dhe 21 prokurorë në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Gjithashtu, gjatë vitit 2022, kanë marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme, 741 prokurorë dhe 84 oficerë të policisë gjyqësore.
- Në qershor 2022, BKH plotësoi numrin total të hetuesve të parashikuar në organigram (60 hetues). 60 hetuesit e BKH morën pjesë në 36 trajnime. Ata janë angazhuar në hetimet e rreth 300 hetimeve procedurale.
- SPAK ka bërë progres drejt funksionalitetit të plotë. Nga 20 pozicione të parashikuara, 17 prokurorë janë ngritur në detyrë si prokurorë në SPAK. Janë organizuar dhe zhvilluar trajnime të posaçme për prokurorët e SPAK.
- Të gjitha masat e parashikuara në OS 3.4 janë zbatuar me sukses nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës.
- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 janë trajnuar 1774 punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (44% e numrit total).
- Është hartuar raporti analitik për kushtet e punës në burgje/identifikimi i problemeve dhe nevojave për përmirësim dhe hartimi i një plan veprimi masash në zbatim të gjetjeve të raportit analitik. Roli aktiv mbështetës i KE në arritjen e shumicës së rezultateve nga DPB.

### **Qëllimi i Katërt i Politikës**

**Koordinimi, manaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucionet e sektorit.**

Për përmbushjen me sukses të këtij qëllimi politik janë arritur rezultatet e mëposhtme:

- Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar udhëzuesin për zhvillimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve si një hap i parë për zhvillimet e ardhshme të sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve gjyqësore.
- Më datë 22.04.2022, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, KLGJ nisi sistemin e ri dhe inovativ online (pilotimi), mbi njoftimet elektronike të avokatëve lidhur me proceset gjyqësore, me qëllim përmirësimin e shërbimit të drejtësisë.
- Është ngritur dhe vënë në funksion rrjeti i intranetit WAN ndërmjet KLGJ-së dhe 38 Gjykatave.
- U krijua një infrastrukturë mbështetëse (Server, Storage, firewal etj.) për rrjetin e klasifikuar me qëllim shkëmbimin e materialeve konfidenciale nga anëtarët e KLGJ. U ngrit gjithashtu

një infrastrukturë mbështetëse (Server, Storage, firewall, etj.) për programin e dixhitalizimit të arkivit gjyqësor.

- Ka filluar zbatimin e Regjistrimit Elektronik të OJF-ve. Ai bazohet në udhëzimet e ligjit 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” dhe parashikohet të hyjë në funksion në fund të vitit 2023.
- Objektivi i Ministrisë së Drejtësisë, në cilësinë e institucionit drejtues për Kriterin Politik dhe Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” në kuadër të procesit të negociatave, është përgatitja për zhvillimin e Takimeve Dypalëshe BE-Shqipëri; përditësimi dhe përmirësimi i dokumenteve të analizës së mangësive ligjore (AML), tabelave të përputhshmërisë (TOC) dhe analizës institucionale dhe administrative (AIA), për Kapitullin 23. Konferenca e Parë Ndërqeveritare ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian u mbajt në Bruksel më 19 korrik 2022. U hartua një plan masash në janar 2022 për të adresuar rekomandimet e raportit të Komisionit për Shqipërinë në 2021 dhe monitorimi i tij vazhdoi gjatë gjithë vitit 2022; Vazhdoi procesi i monitorimit të masave ligjore dhe zbatuese të parashikuara në PKIE 2022-2024 për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”; PKIE 2022-2024 u miratua me VKM nr. 91, datë 09.02.2022;
- Takimet shpjeguese për Kapitullin 23 dhe Funkcionimin e Institucioneve Demokratike u zhvilluan gjatë muajit shtator, si p.sh. takimet dypalëshe BE-Shqipëri për Kapitullin 23 që u mbajtën në datat 24 dhe 25 nëntor 2022.

Përparimi i Reformës në Drejtësi dhe inkuadrimi i saj në një strategji efektive kërkon vullnetin, angazhimin dhe lidhje bashkëpunimi midis të gjithë aktorëve të përfshirë. Këta janë katalizatorë thelbësorë duke marrë në konsideratë rëndësinë e avancimit të kësaj reforme dhe vizionin e saj për të garantuar qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e politikave, për të forcuar integritetin e institucioneve dhe për të nxitur qeverisjen e mirë.

## ***2.2 Impakti i zbatimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritetit evropian***

**Procesi i Integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE)** është konsideruar si prioritet strategjik kombëtar nga shteti shqiptar, në funksion të demokratizimit dhe transformimit të shoqërisë shqiptare, në përputhje me vlerat dhe parimet e Europës së Bashkuar. SND 2021-2025 synon të reflektojë standardet e parashikuara në Kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”. Vizioni i SND 2021-2025 dhe qëllimet e politikës synojnë drejtpërdrejt rritjen e kapaciteteve institucionale për të udhëhequr procesin e përafrimit të legjislacionit me *acquis* e BE-së për këtë kapitull. Zbatimin në mënyrën e duhur të *acquis* në sistemin vendas përbën një ndër kushtet themelore për integrimin evropian të vendit.

**Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë më 12 Tetor 2022:** Shqipëria ka *bërë përparim të mirë*, veçanërisht përmes zbatimit të vazhdueshëm dhe konsolidimit të reformës gjithëpërfshirëse në drejtësi.

**Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025.** Kapitulli 23 është një kapitull thelbësor në procesin e stabilizim-asociimit dhe mbart një rëndësi të veçantë gjatë negociatave për anëtarësim. Ky kapitull mbulon tri fusha të rëndësishme: (1) *sistemin gjyqësor*; (2) *politikën kundër korrupsionit* dhe (3) *të drejtat themelore*. Përafrimi i parimeve me *acquis* e BE-së për kapitullin 23 përbën një detyrim që rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit BE-

Shqipëri. Nenet 1, 2, 13, 70 dhe 78 të MSA-së bartin rëndësi thelbësore për këtë kapitull. Sipas nenit 78, “Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, një rëndësi e veçantë duhet t’i kushtohet forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet administratës në përgjithësi, forcimit të sundimit të ligjit dhe zbatimit të tij, si dhe administrimit të drejtësisë. Përveç kësaj, neni 78 i MSA-së përcakton se bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian duhet të synojë forcimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe përmirësimin e efektivitetit të tij, përmirësimin e funksionimit të organeve të policisë dhe të zbatimit të ligjit, duke siguruar trajnime të përshtatshme dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Gjithashtu, përafrimi me *acquis* dhe standardet e BE-së për kapitullin 23 është një nga kërkesat që vendi kandidat në BE duhet të plotësojë gjatë procesit të negociatave për aderim në Bashkimin Evropian. Më 19 korrik 2022 në Bruksel, u mbajt Konferenca e Parë Ndërqeveritare midis Shqipërisë dhe BE-së, një moment historik i rrugëtimit të integritit evropian të Shqipërisë dhe një hap më afër në realizimin e aspiratës së popullit shqiptar për të qënë pjesë e familjes evropiane. Në përputhje me metodologjinë e re të zgjerimit, negociatat pritet të vijojnë me hapjen e Grupit të Parë të Kapitujve “Themeloret”, ku përfshihen çështjet e gjyqësorit dhe të drejtave themelore.

Në datën 27 shtator 2022 u mbajt takimi shpjegues (*explanatory screening*) për kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” si pjesë e grupit të kapitujve themelorë. Takimet shpjeguese (*explanatory screening*) synojnë qartësimin e bazës së negociimit, praktikisht familjarizimin e shtetit negociues me të gjithë korpusin legjislativ dhe standardet e BE (*acquis*) në fushat respektive. Në këtë takim, Komisioni Evropian prezantoi zhvillimet e fundit të *acquis* në këtë fushë, si dhe ftoi autoritetet shqiptare që të evidentojnë që në këtë fazë të negociatave, iniciativat, mekanizmat, rrjetet dhe skemat e financimit të aplikueshme në këtë fazë vetëm për Shtetet Anëtare të BE. Takimet shpjeguese (*explanatory screening*) u pasuan nga takimet dypalëshe (bilateral screening) të cilat për Kapitullin 23 u zhvilluan në nëntor të këtij vitit 2022. Në këto takime autoritetet shqiptare paraqitën ecurinë dhe progresin në përjasjen e legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE si dhe masat konkrete për zbatimin e këtij legjislacioni. Në vijim të këtyre takimeve, Komisioni Evropian do të hartojë Raportin e Shqyrtimit Analitik (*screening report*). Ky proces dhe hapat vijues të tij është sa teknik edhe politik në natyrë. Për këtë arsye, kohëzgjatja e tij është varësi të shumë faktorëve të cilat lidhen si me progresin e dëshmuar të Shqipërisë, dinamikat e vetë Bashkimit Evropian, si dhe të Shteteve Anëtare.

### ***2.3 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit***

Monitorimi i zbatimit të buxhetit të planit të veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë është një element i rëndësishëm që mundëson analizimin e efektivitetit të progresit të strategjisë. Ky raport monitorimi synon të sigurojë transparencë për çdo palë të interesuar duke prezantuar shpenzimeve të kryera me qëllim marrjen e masave për të adresuar nevojat sa i përket burimeve financiare.<sup>4</sup> Plani i detajuar i veprimit, bashkangjitur si aneks këtij dokumenti strategjik, është hartuar në përputhje me metodologjinë e sistemit IPSIS. Ai është kostuar dhe buxhetet e detajuara parashikohen në të njëjtën mënyrë në sistemin IPSIS, duke ofruar edhe ndarjen e duhur për programet buxhetore sipas institucioneve. Financat do të mbulohen nga buxheti i shtetit, kontrata sektorale “BE-ja për reformën në drejtësi”, nga donatorët në formën





<sup>4</sup> Vlen për tu theksuar se përgjatë dërgimit të kontributit është hasur mungesa e informacionit që lidhet me ekzekutimin e buxhetit.

e granteve, kredive ose çdo fondi tjetër kapital apo asistencë teknike të parashikuar. Kostoja totale për zbatimin e Strategjisë parashikohet të jetë **4,154,621,209 lekë** ose **33,777,408 euro**.<sup>5</sup> Masat e kostuara në planin e veprimit 2021-2025, të cilat janë planifikuar të mbulojnë nga fondet e buxhetit të shtetit, janë brenda fondeve të caktuara për institucionet përgjegjëse, sipas VKM-së nr. 440, datë 22.07.2021, “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”.

Totali i buxhetit të përdorur për periudhën janar-dhjetor 2022 është si më poshtë vijon:

- Financimi nga buxheti i shtetit është në shumën 672,838,250 lekë.
- Financimi nga donatorët është në shumën 0 lekë.<sup>6</sup>

### — Buxheti i përdorur sipas Qëllimeve të Politikës



Gjatë analizës të kryer konstatohet se informacioni i raportuar nga institucionet përgjegjëse i cili lidhet me ekzekutimin e buxhetit rezultojnë i pjesshëm, si dhe mungon plotësisht informacioni mbi financimin nga donatorët<sup>7</sup>.

Gjatë procesit të dërgimit të kontributit nga institucionet haset si problematikë raportimi i masave ku rezultojnë institucion përgjegjës në “kosto administrative” ndërkohë që është parashikuar buxhet për realizueshmërinë e tyre. Gjithashtu, mosraportimi i buxhetit mbi masat përkatëse sjell si pasojë mungesën e një vlere të saktë.

Sipas raportimeve nga institucionet rezultojnë se buxheti i parashikuar për tu shpenzuar në kuadër të Qëllimit të katërt të Politikës për masat të cilat rezultojnë të porealizuara apo në proces zbatimi do të shpenzohet në periudhën në vijim.

<sup>5</sup> Në SND e miratuar rezultojnë se: 1 euro = 123 lekë

<sup>6</sup> Përgjatë periudhës janar-dhjetor 2022 nuk ka informacion mbi financimin nga donatorët për masat e planit të veprimit (informacion i cili nuk disponohet nga të gjitha pikat e kontaktit pranë institucioneve raportuese).

<sup>7</sup> Kjo problematikë është trajtuar në kapitullin “Hapat në vijim”.

### III. PROGRESI LIDHUR ME QËLLIMET E POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË & MASAT


#### 3.1 Përmbledhje e arritjeve në lidhje me Qëllimet e Politikave dhe Objektivat Specifikë sipas masave

SND 2021-2025 parashikon për zbatim gjatë 5 viteve të implementimit të saj 17 Objektiva Specifikë dhe 184 masa. Në analizë për periudhën raportuese janë marrë në konsideratë:

- 16 OS, pasi një prej tyre lidhet me Drejtësisë për të Mitur dhe gjen zbatim në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026;
- 169 masa të cilat janë përcaktuar për tu zbatuar nga institucionet gjatë viteve 2021-2022.

Nga 17 masat që rezultojnë jashtë periudhës së raportimit (të cilat janë paraqitur me ngjyrë të bardhë në tabelat shpjeguese të masave për secilin OS), nga disa prej institucioneve zbatuese rezulton se ka filluar një implementim i lehtë i disa prej tyre, dhe kryesisht i masave që prekin fushën e ngritjes së kapacitetit të stafit.

#### Niveli i realizimit në total: Objektivat specifikë dhe masat



Në vitin 2022, nga 16 Objektivat Specifike, **një (1) është zbatuar plotësisht**, 13 janë zbatuar pjesërisht dhe **dy (2) objektiva nuk janë zbatuar**.

Nga 169 masa gjithsej që kanë filluar zbatueshmërinë në periudhën 2021-2022, **89 masa ose 52% janë zbatuar plotësisht**, 57 masa ose 34% janë zbatuar pjesërisht, dhe **23 masa ose 14% janë të pazbatuara**.




Është gjithashtu e rëndësishme të vlerësohet nëse arritja e OS-ve – në kuadër të mesatares së përqindjes së realizimit të masave – ka pasur zhvillime pozitive duke krahasuar vitin 2021 dhe vitin 2022.

Në përgjithësi, midis vitit 2021 dhe 2022 është shënuar progres në realizimin e të gjitha 16 OS-ve (ose 100%) siç evidentohet në grafik.

### Trendi i realizimit të OS 2021-2022

■ Ka patur progres ■ Është regjistruar ulje



Vlerësimi krahasues i përqindjes së realizimit të secilit nga Qëllimet e Politikës, midis viteve 2021 dhe 2022, tregon gjithashtu progres në lidhje me të katër Qëllimet e Politikës. Edhe pse trendi në periudhën 2021-2022 është në rritje, siç tregohet në grafikun e mëposhtëm, niveli i arritjes së Qëllimit të Katërt të Politikës është më i ulët në krahasim me qëllimet e tjera. Kjo lidhet me përqindjen e ulët të zbatimit të masave dhe numrin e lartë të masave të pazbatuara (15 masa të pazbatuara, ose 38% e masave të Qëllimit të Katërt të Politikës), përkatësisht ato që lidhen me zhvillimin e plotë të sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (OS 4.1 – niveli i zbatimit 21%) dhe përmirësimin e koordinimit, menaxhimit të performancës dhe sistemeve të komunikimit përmes metodologjisë IPSIS (OS 4.2 – niveli i zbatimit 41%).

### Realizimi i Qëllimeve të Politikës gjatë periudhës 2021-2022

















Tabela më poshtë reflekton detajet e arritjeve të secilit Objektiv Specifik për vitin 2021 dhe 2022, si dhe pasqyron një analizë sasiore bazuar mbi realizimin në përqindje të Objektivave Specifikë, përlllogaritur si mesatarja e përqindjes së zbatimit të masave përkatëse. Në Kapitullin III të këtij Raporti pasqyrohen elementë të një analize cilësore të zbatimit të çdo mase.

Objektivat Specifikë		Shkalla e realizimit të masave sipas Objektivit Specifik		
		Viti 2021	Viti 2022	
Qëllimi i I i Politikës	1.1 Vazhdimi i zbatimit dhe finalizimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mënyrë efektive dhe efikase sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligji.	92%	98%	
	1.2 Përditësimi dhe përmirësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, legjislacionin e përditësuar për kompetencat, transparencën, efikasitetin, dhe koordinimin.	83%	91%	
	1.3 Fuqizimi dhe konsolidimi i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet Evropiane, nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, që të kryejnë aktivitetin me pavarësi, efikasitet dhe standarde profesionale, dhe ofrimi i shërbimit të institucioneve të qeverisjes në drejtësi përmbush rregullat dhe standardet përkatëse.	67%	72%	
Qëllimi i II i Politikës	2.1 Rishikimi i kuadrit ligjor në lidhje me gjyqësorin sipas nevojës për të përmirësuar më tej aftësinë profesionale, aksesueshmërinë, transparencën dhe efikasitetin.	56%	67%	
	2.2 Fuqizimi institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese, sigurimi i burimeve të përshtatshme dhe funksionimi i saj profesionale, në mënyrë transparente dhe efektive.	92%	100%	
	2.3 Rritja e efikasitetit dhe aftësisë profesionale të sistemit të trajnimit i cili siguron avancimin drejt praktikave evropiane dhe cilësisë në fushën e drejtësisë duke siguruar një numër të përshtatshëm të magjistratëve dhe këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë të trajnuar për sistemin e drejtësisë në Shqipëri.	78%	89%	
	2.4 Përmirësimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë Gjykatën e Lartë, dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët.	28%	90%	
	2.5 Aksesit efikas në drejtësi i siguruar nëpërmjet ndihmës juridike, zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave gjyqësore të përshtatshme.	78%	87%	

Qëllimi i III i Politikës	3.1 Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë përditësuar duke synuar një qasje të integruar të institucioneve të drejtësisë dhe një qasje restauruese të drejtësisë, ndërtuar mbi parandalimin, risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin duke zëvendësuar qasjen ndëshkuese ekzistuese.	86%	92%	
	3.2 Një sistem prokurorie efikas dhe proaktiv që funksionon sipas standardeve evropiane me qëllim hetimin dhe ndjekja efikase të korrupsionit dhe e krimin të organizuar.	75%	86%	
	3.3 Përmirësimi i drejtësisë për të mitur, duke garantuar një drejtësi miqësore ndaj të miturve, e cila mbron interesin më të lartë të tyre. <sup>8</sup>	-	-	-
	3.4 Një shërbim prove efektiv dhe efikas që përdorstandartet operacionale, metodologjitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimin e individualizuar të çështjeve, mbështet risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin dhe punon në përputhje me praktikatat dhe standartet më të mira të BE-së.	29%	66%	
	3.5 Zhvillimi i sistemit penitenciar bazuar në standartet evropiane, që siguron respekt të plotë për burimet njerëzore dhe përdor plane zhvillimi individuale.	75%	83%	
Qëllimi i IV i Politikës	4.1 Zhvillimi i plotë i sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (e-drejtësia) me identifikues të unifikuar, i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të përditësuar, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të treja fushat (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare.	13%	21%	
	4.2 Përmirësimi i koordinimit, menaxhimit të performancës dhe të sistemeve të komunikimit përmes metodologjisë IPSIS.	28%	42%	
	4.3 Zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë, i burimeve dhe i mbështetjes për institucionet e saj të varësisë.	53%	67%	
	4.4 Përditësimi i kuadrit ligjor dhe kapaciteteve të MD-së dhe përmirësimet në fushën e bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar dhe përgatitja e Shqipërisë për anëtarësimin në BE me anë të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me <i>acquis</i> e BE dhe aktet e tjera të integritimit me BE dhe shtetet anëtare në fushën e drejtësisë.	55%	81%	

### 3.2 Vlerësimi i arritjes së Qëllimeve të Politikës kundrejt masave dhe treguesve

<sup>8</sup> Objektivi 3.3 nuk është përfshirë në planin e veprimit të SND 2021-2025 për të shmangur mbivendosjen me masat e parashikuara në Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur.


### 3.2.1 Qëllimi i Parë i Politikës

*Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien.*

Gjatë vitit 2022 janë bërë hapa të mëtejshëm drejt arritjes së Qëllimit të Parë të Politikës. Gjatë periudhës së raportimit, të tre objektivat specifikë në lidhje me Qëllimin e Parë të Politikës janë zbatuar pjesërisht. Nga 22 masat e lidhura me këtë synim, **14 masa u zbatuan plotësisht** dhe **8 masa u zbatuan pjesërisht**. Nuk pati asnjë masë të pazbatuar.

Për sa i përket vitit 2022, Plani i Veprimit parashikon pesë (5) masa për OS 1.1, 12 masa për OS 1.2 dhe 5 masa për OS 1.3. Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (**të zbatuara plotësisht/të zbatuara pjesërisht/të pazbatuara**).

#### Qëllimi i Parë i Politikës



Është parashikuar një tregues në nivelin e Qëllimit të Parë të Politikës:

- **% e subjekteve të rivlerësimit kalimtar që besojnë se institucionet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë janë të pavarura dhe të paanshme**

Treguesi synon të masë nëpërmjet një pyetësi të hartuar nga KLGJ dhe KLP punën e institucioneve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë nëpërmjet perceptimit të subjekteve të rivlerësimit kalimtar. Informacionet e raportuara dhe analizuar tregojnë se një vlerësim i tillë nuk është bërë.

Tabelat e mëposhtme përmbledhin dhe vlerësojnë veprimet kryesore të ndërmarra nga institucionet në drejtim të zbatimit të masave në Planin e Veprimit në lidhje me secilin prej tre Objektivave Strategjike të Qëllimit të Parë të Politikës. Detajet e plota të dhëna nga institucionet raportuese mund të gjenden në Planin e Veprimit.

#### Objektivi Specifik 1.1.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.1 parashikon 5 masa, **katër (4) prej të cilave janë zbatuar plotësisht** dhe një (1) është zbatuar pjesërisht (80% e masave janë zbatuar plotësisht - niveli

i tolerances “mirë”). Niveli i realizimit të OS 1.1. sipas mesatares së përqindjes së zbatimit të masave është 98%.

<b>OS 1.1: Vazhdimi i zbatimit dhe finalizimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mënyrë efektive dhe efikase sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligjit.</b>	
1.1.1	<p><i>Përgatitja dhe konsolidimi i raporteve të verifikimit kalimtar të subjekteve të vlerësimit nga organet ekzistuese të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në mandatin ekzistues. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA)</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për periudhën 1 janar 2022 deri më 31 dhjetor 2022 ka dhënë gjithsej 118 vendime, prej tyre 57 për konfirmim në detyrë (26 gjyqtarë dhe 29 prokurorë) dhe 36 shkarkime nga detyra. Plani i Veprimit përmban detaje në lidhje me llojin e vendimeve të dhëna nga KPK në vitin 2022.</p>
1.1.2	<p><i>Mbështetje ligjore dhe buxhetore për organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Kuvendi</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Kuvendi i Shqipërisë u ka dhënë organeve të rivlerësimit fonde shtesë nga ato të propozuara fillimisht në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, sipas kërkesave të tyre.</p> <p>Kuvendi i Shqipërisë me vendimet e tij nr. 35, 36 dhe 37, datë 12.05.2022, miratuan ndryshimet strukturore të tre organeve të rivlerësimit: KPA-së, KPK-së dhe Komisionerit Publik. Ndryshimet e miratuara në strukturat e këtyre institucioneve janë shumë të rëndësishme për progresin e punës me synimin për të përmbyllur procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.</p>
1.1.3	<p><i>Finalizimi i raporteve të vlerësimit përfundimtar. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> KPK, KPA<sup>9</sup></p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Gjatë vitit 2022 kanë qenë në proces 133 raporte vlerësimi/dosje rivlerësimi, dhe 118 prej tyre janë finalizuar me vendim të KPK-së.</p>
1.1.4	<p><i>Rishikimi i kuadrit ligjor për organet e qeverisjes së drejtësisë dhe përfshirja e përvojave të mira në legjislacionin e rishikuar. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Komisioni i Pavarur i Kualifikimit</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Zgjatja e mandatit të Komisionerëve të KPK-së, nga 5 vjet deri më 31.12.2024 me propozimin ligjor për ndryshimin e Kushtetutës, neni 179/b. Statusi i masës zbatohet plotësisht me ligjin nr. 16/2022 datë 10.2.2022.</p>
1.1.5	<p><i>Rishikimi i rregulloreve të brendshme të organeve të qeverisjes në sistemin e drejtësisë dhe përfshirja e praktikave të mira në rregulloret e rishikuara. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Komisioni i Pavarur i Kualifikimit</p>

<sup>9</sup> Pjesë e raportimit për këtë masë është vetem Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (KPK). Raportimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA) bazuar në organizimin dhe funksionim e tij konsiston vetëm në të dhënat statistikore lidhur me ecurinë e procesit të rivlerësimit si dhe koston në buxhet të aktivitetit të parashikuar për vitin përkatës.

### Informacion mbi zbatimin e masës:


Ndryshimi i strukturës dhe stafit nga Kuvendi i Shqipërisë është reflektuar nëpërmjet përshkrimeve të vendeve të punës dhe rekrutimit të specialistëve.

Për OS 1.1 është përcaktuar një tregues performance:

- **% e gjyqtarëve që kanë përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar nga organet e sistemit të drejtësisë.<sup>10</sup>**

Sipas pasaportës së indikatorëve, vlera e synuar për vitin 2022 ishte 75% e numrit total të subjekteve të rivlerësimit (805 subjekte në fillim të procesit). Vlera e synuar e treguesit për vitin 2022 është arritur. Treguesi i vitit 2022 regjistron gjithashtu progres, krahasuar me vitin e mëparshëm, në realizimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

### Gjyqtarët dhe prokurorët që kanë përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar



■ Kanë përfunduar ■ Nuk kanë përfunduar



### Pikat kryesore për OS 1.1:

- Procesi i rivlerësimit kalimtar për gjyqtarët dhe prokurorët është kryer nga organet e rivlerësimit në vitin 2022 duke ndjekur planet dhe duke marrë parasysh përfundimin e mandatit të zgjatur – dhjetor 2024.
- Ndryshimet kushtetuese kanë dhënë garancitë e nevojshme që organet e rivlerësimit të përfundojnë në kohë të gjithë procesin.
- Njëkohësisht me këtë proces që është në vazhdim, i cili çon në zvogëlimin e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, gjykatat dhe prokuroritë kanë tashmë një ngarkesë të pazgjidhur, e cila mund të kompensohet vetëm nëpërmjet vendosjes së një “pakete” masash dhe përfshirjes së të gjithë aktorëve përkatës në gjetjen e zgjidhjes më të mirë.

<sup>10</sup> Targeti i vendosur është pjesë e analizës vetëm për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK). Raportimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit bazuar në organizimin dhe funksionim e tij konsiston vetëm në të dhënat statistikore lidhur me ecurinë e procesit të rivlerësimit si dhe koston në buxhet të aktivitetit të parashikuar për vitin përkatës.

## Objektivi Specifik 1.2.

Plani i Veprimit për Objektivin Specifik 1.2 parashikon 12 masa, prej të cilave **9 janë zbatuar plotësisht** dhe **3 janë zbatuar pjesërisht** (75% e masave janë zbatuar plotësisht - niveli i tolerances “mirë”). Niveli i realizimit të OS 1.2. sipas mesatares së përqindjes së zbatimit të masave është 91%.

<b>OS 1.2: Përditësimi dhe përmirësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, legjislacionin e përditësuar për kompetencat, transparencën, efikasitetin, dhe koordinimin.</b>	
1.2.1	<p><i>Përgatitja e analizës së zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLGJ-në.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Për të përmirësuar kuadrin rregullator në përputhje me situatën e krijuar në sistemin gjyqësor për shkak të vendeve vakante, përpjekjeve për normalizimin e funksionimit të gjykatave, mungesës së burimeve njerëzore, KLGJ-ja i ka propozuar Komisionit Parlamentar të Ligjeve, në Kuvendin e Shqipërisë, opinione mbi nevojën për disa shtesa dhe ndryshime të nevojshme në 7 ligje,</p> <p>Sugjerimet e ofruara nga Këshilli, disa prej të cilave tashmë janë pasqyruar në ligjet e miratuara, kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit të gjykatave.</p>
1.2.2	<p><i>Përgatitja e përgjigjes mbi analizën e rishikimit të ligjit mbi statusin dhe strukturën qeverisëse të KLGJ-së (draftpropozimet ligjore).</i> (pz 2021-2021)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Propozimet për ndryshime ligjore për ligjet 96 dhe 115 janë dërguar në tetor të vitit 2022 në Kuvend. Bazuar në parimin e sigurisë juridike të normës, nuk rekomandohet që ndryshimet në legjislacion të jenë të shpeshta, por vetëm pasi zbatimi i tyre të monitorohet dhe analizohet gjatë një kohe të caktuar dhe të mjaftueshme zbatimi. Si rezultat i kësaj, KLGJ-ja bëri propozimin për ndryshime ligjore në vitin 2022 vetëm pasi kishte analizuar me kujdes zbatimin.</p>
1.2.3	<p><i>Finalizimi i rishikimit të kuadrit ligjor të lidhur me qeverisjen e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLGJ-në (konsultimi dhe miratimi i akteve).</i> (pz 2021-2022)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Disa shtesa dhe ndryshime janë propozuar për ligjin nr. 96/2016, Ligjin nr. 115/2016, Ligjin nr. 98/2016. Disa prej tyre tashmë janë pranuar nga Kuvendi, por propozimet e sugjeruara në vitin 2022 janë ende pezull në Kuvend.</p> <p>KLGJ-ja është e përfshirë në mënyrë aktive në disa aktivitete lidhur me rishikimin e kuadrit ligjor dhe propozimet për amendamentet e ligjeve që lidhen me funksionet e KLGJ-së dhe të sistemit gjyqësor në Shqipëri.</p>
1.2.4	<p><i>Rishikimi dhe konsolidimi i rregullave të brendshme të KLGJ-së.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Draft rregullorja është në proces finalizimi për të pasqyruar komentet e partnerëve ndërkombëtarë.</p>

	<p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Procesi i miratimit të Rregullores së Brendshme është shumë i gjatë. KLGJ do të angazhohet për të përshpejtuar procesin e miratimit përfundimtar të Rregullores së brendshme.</p>
1.2.5	<p><b><i>Përgatitja e analizës së zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLP-në.</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë i Prokurorisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Analiza e bërë nga KLP-ja në mënyrë të vazhdueshme lidhet me aktet që Këshilli do të hartojë dhe miratojë me ligj. Bazuar në këtë analizë dhe aktet nënligjore të miratuara tashmë nga KLP-ja (si psh. lëvizja paralele, ngritja në detyrë në pozicione drejtuese, transferimet dhe caktimet e përkohshme, ngritja në detyrë në Prokurorinë e Posaçme, ngritja në detyrë i drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme)</p> <p>Nga KLP-ja u sqarua se fokusi kryesor në vitin 2022 do të jetë vlerësimi etiko-profesional i prokurorëve.</p> <p>U miratua me Vendimin nr. 95, datë 09.05.2022, Rregullorja për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve e ndjekur nga Vendimi nr. 140, datë 06.06.2022, për miratimin e Programit që përcakton listën e prokurorëve për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional për vitin 2022 dhe Vendimit nr. 141, datë 06.06.2022, u miratua plani 3-mujor i vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve. Gjithashtu, me Vendimin nr.313, datë 30.11.2022, KLP ka miratuar programin që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional individual përgjatë vitit 2023.</p> <p>Më tej, me Vendimin nr.316, datë 02.12.2022, është miratuar plani tre-mujor i vlerësimit etik dhe profesional i prokurorëve për vitin 2023.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Ka ende akte nënligjore të cilat duhet të miratohen nga KLP-ja bazuar në kërkesat e Ligjit për Statusin dhe Ligjit për Qeverisjen. Mungesa e disa akteve të rëndësishme nënligjore krijon rrezik për zbatimin e dispozitave ligjore bazuar në interpretime të ndryshme. Përpunimi dhe miratimi i të gjitha akteve nënligjore të parashikuara nga legjislacioni parësor do të jetë prioritet i KLP-së.</p>
1.2.6	<p><b><i>Përgatitja e përgjigjes mbi analizën e rishikimit të ligjit mbi statusin dhe strukturën qeverisëse të KLP-së (draftpropozimet ligjore).</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë i Prokurorisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>KLP-ja ka bashkëpunuar në vazhdimësi me Ministrinë e Drejtësisë, duke dhënë mendimin e saj sa herë që një projektligj paraqitet për mendim, si dhe duke paraqitur në takime të ndryshme shqetësimet dhe nevojat që të ndryshohet legjislacioni në fuqi. Për vitin 2022, ishin parashikuar dy propozime. Për këtë arsye masa është realizuar 50% pasi është paraqitur vetëm një propozim për ligjin Nr.96/2016 dhe ligjin Nr.115/2016.</p>
1.2.7	<p><b><i>Finalizimi i rishikimit të kuadrit ligjor të lidhur me qeverisjen e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLP-në (konsultimi dhe miratimi i akteve).</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë i Prokurorisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Bazuar në rishikimin e kuadrit ligjor, KLP-ja ka krijuar Grupe Pune për hartimin e akteve të tjera, për të cilat ligji nr. 96/2016 dhe ligji nr. 115/2016 ka ngarkuar Këshillat që të rregullojnë aspekte ndryshme në mënyrë më të detajuar, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të rregulloreve.</p>
1.2.8	<p><b><i>Rishikimi dhe konsolidimi i rregullave të brendshme të KLP-së.</i></b> (pz 2021-2025)</p>



	<p><b>Institucioni raportues:</b> Këshilli i Lartë i Prokurorisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>“Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të KLP-së” është miratuar me Vendimin nr. 407 të KLP-së, datë 17.12.2021.</p>
1.2.9	<p><b><i>Përgatitja e analizës së zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me ILD-në.</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Gjatë vitit 2022 ILD-ja raporton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i. 789 ankesa të reja të paraqitura në ILD;</li> <li>ii. Gjithsej janë trajtuar 1715 ankesa, nga të cilat 534 janë ankesa të fondit backlog; :</li> <li>iii. 28 vendime për e hetim disiplinor me atë të cilave janë hetuar shkeljet e pretenduara ndaj veprimtarisë së 41 magjistratëve</li> <li>iv. 6 kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor për 6 magjistratë janë paraqitur pranë KLGJ dhe KLP</li> <li>v. Janë realizuar tre inspektime tematike dhe 2 prej tyre kanë përfunduar, të cilat janë vënë në dispozicion të organeve kompetente, së bashku me rekomandimet për adresimin e problemeve të hasura.</li> </ul> <p>Me vendimin nr. 44, datë 11.10.2022 ILD-ja ka emëruar 4 inspektorë jomagjistratë. Aktualisht numri i inspektorëve është 12, nga të cilët 4 inspektorë magjistratë dhe 8 inspektorë jomagjistratë. Gjithashtu, për 7 nëpunës civilë janë mbyllur procedurat dhe janë emëruar 2 këshilltarë.</p>
1.2.10	<p><b><i>Përgatitja e përgjigjes mbi analizën e rishikimit të ligjit mbi statusin dhe strukturën qeverisëse të ILD-së (draft-propozimet ligjore).</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Nëpërmjet shkresës nr. 2922 prot., datë 02.12.2020, ILD-ja i dërgoi Ministrisë së Drejtësisë propozime për ndryshime ligjore në ligjin nr. 115/2016 “Për institucionet e qeverisjes” i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.</p> <p>Një nga propozimet e rëndësishme është ndryshimi i kriterëve për dërgimin e magjistratëve në pozicionin e inspektorit në KLGJ, duke parashikuar mundësinë e emërimit në këto pozicione të magjistratëve, që plotësojnë kriteret për t’u ngritur në detyrë, në pozicione në gjykatat e apelit apo në prokurori (shtatë (7) vjet). Arsyeja e këtij propozimi është fakti se gjyqtarët me më shumë se 13 vjet përvojë (në përputhje me kriterin aktual) nuk kanë aplikuar për t’u komanduar si inspektorë.</p> <p>Propozimet i janë drejtuar Kuvendit dhe janë në proces shqyrtimi.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b> Mungesa e gjyqtarëve të emëruar si inspektorë e ILD-së krijon një “boshllëk” në grupin e përvojave dhe njohurive të mëparshme të inspektorëve në detyrë. Ky fakt ndikon edhe në disa aspekte të inspektimeve, sidomos kur bëhet fjalë për veprimtarinë e gjykatave dhe të gjyqtarëve. Nevojitet një angazhim i shtuar nga institucionet për të siguruar në të ardhmepërfshirjen e gjyqtarëve si inspektorë pranë ILD-së, nëpërmjet amendimeve të ligjit duke motivuar ëëgjyqtarët me përvojë të aplikojnë për tu transferuar si inspektorë pranë ILD-së.</p>
1.2.11	<p><b><i>Rishikimi dhe konsolidimi i rregullave të brendshme të ILD-së.</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p>


	Gjatë periudhës raportuese janë hartuar dhe miratuar gjithsej 22 urdhra të përgjithshëm me karakter administrativ, që kanë të bëjnë me çështje të organizimit dhe funksionimit, menaxhimit dhe kontrollit financiar. Gjithashtu, ILD-ja ka miratuar metodologjinë e inspektimit, e cila synon të vërë në dispozicion të njësisë së inspektorëve të ILD-së një mjet të dobishëm procedural për zbatimin e legjislacionit për përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve, rritjen e transparencës dhe vendosjen e standardeve të larta të punës, të cilat kontribuojnë në forcimin dhe rritjen e besimit në organet e sistemit të drejtësisë.
1.2.12	<p><b>Përgatitja e një plani operacional të ILD-së për trajtimin e ankesave te prapambetura.</b> (pz 2021-2025)</p> <p><b>Institucioni raportues:</b> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><b>Informacion mbi zbatimin e masës:</b></p> <p>Në lidhje me këtë aktivitet, ILD-ja ka përgatitur një plan operacional, për ecurinë e trajtimit të ankesave sipas kategorizimit, identifikimit të tyre dhe prioritetit të trajtimit. Zbatimi i planit është në fund. Në vitin 2022, bazuar në Plan, ILD-ja ka përfunduar 534, ankesa të fondit backlog dhe pritet që e gjithë pjesa e prapambetur të përfundojë në vitin 2023.</p>

Për OS 1.2 janë përcaktuar dy tregues performance:


- **Numri i akteve nënligjore të miratuara në lidhje me kompetencat, efikasitetin dhe koordinimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (vlera të ndara për KLGJ/KLP/ILD).**

Vlerat e synuara për këtë tregues, të përcaktuara në pasaportën e treguesve, janë arritur dhe tejkaluara në vitin aktual të raportimit (2022), duke reflektuar arritje më pozitive në realizimin e traqetit në krahasim me vitin paraardhës (2021).

**Akte nënligjore të miratuara nga institucionet e drejtësisë (2021)**



**Akte nënligjore të miratuara nga institucionet e drejtësisë (2022)**




**Realizimi i targetit 2022**

	Targeti	Vlera e raportuar	Realizimi i targetit
<b>KLJGJ</b>	8	10	125%
<b>KLP</b>	4	5	125%
<b>ILD</b>	4	22 <sup>11</sup>	550%


➤ **Numri i propozimeve për ndryshime ligjore të bëra nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.**

Vlerat e synuara për këtë tregues, të përcaktuara në pasaportën e indikatorëve, nuk janë arritur në vitin aktual të raportimit (2022). KLP raportoi një grup ndryshimesh për të dy ligjet kyçe të reformës, Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, si dhe Ligji Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILD raportoi se nuk janë prezantuar inisiativa për ndryshime ligjore pasi paketa e propozimeve të paraqitura në 2020 është akoma në proces shqyrtimin nga Kuvendi.

**Ndryshimet ligjore të propozuara nga institucionet e drejtësisë (2021)**



**Ndryshimet ligjore të propozuara nga institucionet e drejtësisë (2022)**



<sup>11</sup> Për vitin 2022 në funksion të zbatimit të kompetencave ligjore dhe përmirësimit të veprimtarisë janë hartuar dhe miratuar në total 22 urdhra të përgjithshëm me karakter administrativ

Realizimi i targetit 2022			
	 Targeti	 Vlera e raportuar	 Realizimi i targetit
<b>KLJGJ</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>100%</b>
<b>KLP</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>50%</b>
<b>ILD</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>0%</b>

### Pikat kryesore për OS 1.2

- Institucionet e pavarura të qeverisjes në sektorin e drejtësisë, KLJGJ, KLP dhe ILD kanë vijuar zbatimin e legjislacionit përkatës duke u përballur me sfida dhe kufizime që lidhen me funksionet dhe aktivitetet e tyre.
- KLJGJ, KLP dhe ILD kanë përfunduar analizat e tyre në lidhje me kuadrin ligjor të institucioneve të tyre dhe kanë sugjeruar disa ndryshime në Ligjin për Statusin dhe Ligjin e Qeverisjes si dhe disa ligje të tjera përkatëse.
- Të dy Këshillat ende duhet të përmbushin detyrimet e tyre për nxjerrjen e akteve nënligjore siç parashikohet nga legjislacioni parësor. Në krahasim me KLJGJ, KLP ka më shumë akte nënligjore që do të përfundohen, miratohen dhe zbatohen në vijim.
- ILD ka nxjerrë një numër të konsiderueshëm urdhrash dhe aktesh administrative që rregullojnë në mënyrën më të mirë, organizimin dhe funksionimin e brendshëm të ILD.
- ILD ka kryer 3 inspektime tematike në bazë të Metodologjisë së miratuar. Dy prej tyre janë plotësuar dhe raportet i janë dërguar institucioneve përkatëse për zbatimin e rekomandimeve.
- Ankesat e prapambetura (*backlog*) të Zyrës së ILD janë në proces për t'u analizuar dhe finalizuar plotësisht nga ILD.

### Objektivi Specifik 1.3.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.3 parashikon 5 masa, prej të cilave **1 është zbatuar plotësisht e realizuar** dhe **4 janë zbatuar pjesërisht (vetëm 20% e masave është zbatuar plotësisht - niveli i tolerances “dobët”)**. Niveli i realizimit të OS 1.3. sipas mesatares së përqindjes së zbatimit të masave është 72%.

**OS 1.3: Fuqizimi dhe konsolidimi i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përfundim me standardet Evropiane, nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, që të kryejnë aktivitetin me pavarësi, eficientë dhe standarde profesionale, dhe ofrimi i shërbimit të institucioneve të qeverisjes në drejtësi përmbush rregullat dhe standardet përkatëse.**

1.3.1 *Përfundimi i procedurave të emërimit, promovimit, transferimit të magistratëve të diplomuar nga Shkolla e Magistraturës. (p.z 2021-2025)*

	<p><b>Institucioni raportues:</b> Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>KLP: Me Vendimet nr. 165-187, datë 12.07.2022 të KLP-së, janë emëruar 22 prokurorë të rinj. Sa i përket SPAK-ut, gjatë vitit 2022 KLP-ja ka emëruar me procedurë ngritjeje në detyrë drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, me mandat 3-vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje. Një procedurë lëvizjeje paralele dhe 1 ngritje në detyrë prokurori janë kryer në vitin 2022.</p> <p>KLGJ: Janë diplomuar 24 magjistratë të rinj dhe janë emëruar 23 magjistratë të profilit gjyqtar. 3 gjyqtarë u deleguan në gjykatat e apelit dhe 6 gjyqtarë u ngritën në detyrë në Gjykatën e Lartë, 7 juridiksionit të përgjithshëm, dhe 4 në gjykatat e posaçme (për korrupsionin dhe krimin e organizuar 3 dhe 1 në gjykatën administrative te apelit). Gjatë vitit 2022 Këshilli ka vendosur caktimin në skemë delegimi të 6 gjyqtarëve dhe zgjatjen e afatit të caktimit për 4 gjyqtarë të tjerë (10 në total).</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>KLGJ do të vijojë procesin për një magjistrat gjyqtar të diplomuar nga SHM.</p> <p>Anëtarët e KLP-së dhe komisionet e përhershme përkatëse do të jenë më aktivë në procedurat e ngritjes në detyrë dhe lëvizjes paralele të cilat janë në proces dhe priten të përfundojnë gjatë vitit 2023.</p>
1.3.2	<p><b><i>Përfundimi i procedurave të emërimit të inspektorëve magjistratë dhe jo-magjistratë pranë ILD-së si dhe përfundimi i rekrutimeve të stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</i></b> (pz 2021-2023)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Gjatë vitit 2022, brenda strukturës së miratuar janë bërë gjithsej 12 emërime/rekrutime. Aktualisht numri i punonjësve sipas strukturës për vitin 2022 është 93 (punonjës të miratuar). Numri i përgjithshëm i punonjësve që kryejnë efektivisht detyrën e tyre është 71.</p> <p>ILD-ja i ka propozuar Kuvendit të Shqipërisë disa ndryshime strukturore, të cilat fokusohen në ndryshimin organizativ të njërive, duke i kushtuar vëmendje të veçantë zhvillimit dhe forcimit të metodave të punës dhe matjes së performancës, si dhe konceptit të statistikave të gjurmueshme.</p>
1.3.3	<p><b><i>Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të inspektorëve të drejtësisë nëpërmjet trajnimeve specifike për pozicionet e punës.</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Për sa i përket aktiviteteve të trajnimit gjatë vitit 2022, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në bashkëpunim me institucione dhe organizata ndërkombëtare, ka marrë pjesë në 2 trajnime me Inspektoratin e Prokurorisë së Kurorës së Madhërisë së Saj (HMCPSI) dhe Inspektoratin e Përgjithshëm të Drejtësisë të Republikës së Italisë.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Në vitin 2022 nuk janë organizuar trajnime në punë, trajnime për formim të vazhduar për inspektorët dhe këshilltarët ligjorë, gjë që paraqet risk për performancën e mëtejshme profesionale, veçanërisht të inspektorëve të sapoemëruar dhe të komanduar dhe anëtarëve të tjerë të stafit. Rekomandohet që ILD dhe ShM me asistencën e donatorëve të hartojnë një program për trajnime të vazhdueshme për vitin 2023.</p>
1.3.4	<p><b><i>Përgatitja e raporteve të analizës së grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të mbartura nga institucionet e tjera, sipas objektit.</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p>

	<p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Gjatë vitit 2022, nga 1606 ankesa nga fondi backlog të mbetur në proces trajtimi në përfundim të vitit 2021 , janë trajtuar 534 prej tyre dhe 1072 ankesa do të trajtohen gjatë vitit 2023.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Procesi i shqyrtimit, analizimit dhe vendosjes për ankesat e prapambetura është në fund dhe do të finalizohet në vitin 2023. Kështu, ILD do të vazhdojë të punojë edhe për ankesat e marra edhe pas krijimit të tij.</p>
1.3.5	<p><b><i>Përgatitja e ndërhyrjeve të nevojshme për përmirësimin infrastrukturor dhe logjistik të ILD për pajisjen me ambiente pune/logjistikë për të gjithë numrin e punonjësve të ILD-së.</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Pas përfundimit të procedurës së prokurimit, zbatimi i projektit (rindërtimi i objektit) do të fillojë në shkurt të vitit 2023.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Rikonstruksioni i ndërtesës ka të bëjë me buxhetin dhe përfshirjen e disa institucioneve të tjera. Risku për finalizimin në kohë të rikonstruksionit ekziston, por nuk varet nga ILD.</p>

Për OS 1.3 janë përcaktuar tre tregues performance:


➤ ***% e buxhetit të shtetit dedikuar organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë***

Vlerat e synuara për këtë tregues, të përcaktuara në pasaportën e indikatorëve, janë arritur pjesërisht, si në vitin aktual të raportimit (2022), ashtu edhe në vitin paraardhës (2021).

**% e buxhetit të shtetit dedikuar organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (2021)**



**% e buxhetit të shtetit dedikuar organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (2022)**



Realizimi i targetit 2022			
	 Targeti	 Vlera e raportuar	 Realizimi i targetit
<b>KLGG</b>	0.089%	0.075%	84%
<b>KLP</b>	0.045%	0.045%	100%
<b>ILD</b>	0.06%	0.079%	132%

➤ ***Përqindja e procedurave të filluara disiplinore për ankesat kundër gjyqtarëve ose prokurorëve***


Treguesi mat raportin midis numrit të ankesave për të cilat është marrë vendim për fillimin e hetimit disiplinor nga ILD dhe numrit të kërkesave për procedim disiplinor pranë Këshillave, i shprehur si përqindje. Në vitin 2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë miratoi 28 vendime për fillim të hetimit disiplinor ndaj magjistratëve dhe paraqiti 6 kërkesa për masa disiplinore - 3 kërkesa në lidhje me gjyqtarët (KLGG dhe 3 kërkesa në lidhje me prokurorët përpara KLP. Përqindja e procedimeve disiplinore të filluara ndaj gjyqtarë apo prokurorë është 21.4% (6/28x100). Gjithsesi ky tregues rezulton në nevojën për rishikim.

➤ ***Treguesi i zgjidhjes së çështjeve të prapambetura për disiplinën e ankesave të paraqitura në ILD.***

Indikatori përlllogaritet si raporti i numrit total të ankesave disiplinore të prapambetura me numrin e ankesave të trajtuara. Vlera e synuar për vitin 2022 për këtë indikator, siç përcaktohet në pasaportën e indikatorëve, është 62% (1000 çështje në 2022 nga 1606 çështje backlogu në fillim të vitit 2022). Siç tregohet në tabelën më poshtë, ILD ka reduktuar në mënyrë progresive ngarkesën fillestare prej 2104 çështjesh të prapambetura, të trashëguara nga institucionet e mëparshme kur u krijua, në shkurt 2020. Megjithatë, ILD arriti të trajtojë vetëm 49% të çështjeve të prapambetura deri në fund të vitit 2022.

Sipas targeteve të përcaktuara në pasaportën e indikatorëve, të gjitha çështjet e prapambetura – pra 51% e çështjeve, ose 1,072 çështje të prapambetura – duhet të zgjidhen deri në fund të vitit 2023.

**ILD - backlogu**





### Pikat kryesore për OS 1.3.

- 23 gjyqtarë të rinj dhe 22 prokurorë të diplomuar në ShM janë emëruar nga KLGJ dhe KLP në vitin 2022.
- KLGJ ka promovuar 6 gjyqtarë në GjL, 11 gjyqtarë në Gjykatat e Apelit.
- Ngritja në detyrë e gjyqtarëve në GjL në vitin 2022 ka qenë një hap i rëndësishëm përpara për GjL dhe marrjen e masave për zgjidhjen e çështjeve të prapambetura.
- Miratimi i udhëzimit Nr.1, datë 26.5.2022 “Për përcaktimin e rregullave për heqjen dorë nga rekursat e depozituara nga administrata shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, të pashqyrtuara nga Gjykata e Lartë, për disa çështje me natyrë civile dhe administrative”.
- ILD ka trajtuar 534 çështje të prapambetura në vitin 2022, duke arritur të trajtojë 49% të totalit të ankesve të prapambetura deri në fund të vitit 2022.

### 3.2.2 Qëllimi i Dytë i Politikës

*Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane.*


Për sa i përket arritjes së Qëllimit të Dytë të Politikës, gjatë periudhës së raportimit një (1) nga Objektivat Specifikë është zbatuar plotësisht dhe katër (4) janë zbatuar pjesërisht. Nga 61 masat e lidhura me këtë qëllim, 55 masa kanë filluar zbatueshmërinë në periudhën 2021-2022. Nga këto 55 masa, **36 masa janë zbatuar plotësisht**, 15 masa janë zbatuar pjesërisht dhe **4 masa janë të pazbatuara**.

Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (**të zbatuara plotësisht**/të zbatuara pjesërisht/**të pazbatuara**). Masat të cilat fillojnë periudhën e zbatueshmërisë pas vitit 2022 janë prezantuar me sfond të bardhë.

### Qëllimi i Dytë i Politikës



## 55 MASA TE ZBATUESHME NË 2021-2022



Është parashikuar një tregues në nivelin e Qëllimit të Dytë të Politikës:

➤ ***Treguesi i zgjidhjes së çështjeve të prapambetura për Gjykatën e Lartë***

Sipas metodologjisë së përcaktuar në pasaportën e indikatorëve, treguesi synon të mase kohën e nevojshme për zgjidhjen e çështjeve të mbartura. Treguesi, i njohur edhe si ‘disposition time DT’ plllogarit kohën teorike të nevojshme për zgjidhjen e një çështjeje të mbartur duke marrë parasysh numrin e çështjeve të zgjidhura gjatë vitit dhe numrin e çështjeve të mbartura në vitin pasardhës (indikator i zhvilluar nga CEPEJ).<sup>12</sup>


Objektivat e përcaktuara në pasaportën e treguesve synojnë të ulin në mënyrë progresive kohëzgjatjen e nevojshme për zgjidhjen e çështjeve të mbartura. Treguesi ka trend zbritës, dhe sa më e ulët të jetë koha e nevojshme për zgjidhjen e çështjeve të mbartura në fund të vitit, aq më pozitive është performanca e Gjykatësë. Për vitin 2022, KLGJ ka raportuar se Gjykata e Lartë ka arritur të ulë stokun e çështjeve të prapambetura me 12%, ndërsa në vitin 2021 ulja e stokut ishte vetëm 1%.

Duke patur parasysh numrin e lartë të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë për arsye të mungesës së funksionalitetit të plotë të kësaj Gjykate gjatë periudhës 2018-2021, për vitin 2022 targetet e përcaktuara në pasaportën e indikatorëve janë: 20 vjet për zgjidhjen e çështjeve civile, 11 vjet për zgjidhjen e çështjeve administrative dhe 6 vjet për zgjidhjen e çështjeve penale të mbartura.

Sipas raportimeve në kuadrin e takimeve bilaterale KLGJ ka raportuar të dhënat e paraqitura në grafikët si më poshtë.

<sup>12</sup> Formula për llogaritjen e DT është:  $DT = \frac{\text{Numri i çështjeve të mbartura në fund të periudhës raportuese}}{\text{Numri i çështjeve të zgjidhura në këtë periudhë}} \times 365$

## DT e çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë (në ditë)



### Objektivi Specifik 2.1.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.1 parashikon 14 masa, prej të cilave një masë (masa 2.1.14) fillon zbatueshmërinë në vitin 2024.

Nga 13 masat që kanë filluar zbatueshmërinë në periudhën 2021-2022, **4 masa janë zbatuar plotësisht**, **7 masa janë zbatuar pjesërisht**, dhe **2 masa rezultojnë të pazbatuara** (31% e masave janë zbatuar plotësisht - niveli i tolerances “mjaftueshëm”. Niveli i realizimit të OS 2.1. sipas mesatares së përqindjes së realizimit të masave është 67%.

**OS 2.1: Rishikimi i kuadrit ligjor në lidhje me gjyqësorin sipas nevojës për të përmirësuar më tej aftësinë profesionale, aksesueshmërinë, transparencën dhe efijencën.**

2.1.1 *Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të Kodi i Procedurës Civile (KPC). (pz 2021-2025)*

**Institucioni raportues:** Ministria e Drejtësisë

**Informacion mbi zbatimin e masës:**

Masa u zbatua në 2020-2021.

2.1.2 *Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të KPC-së. (pz 2021-2025)*

**Institucioni raportues:** Ministria e Drejtësisë

**Informacion mbi zbatimin e masës:**

Zbatuar në vitin 2021.

2.1.3 *Kryerja e analizës së rishikimit të funksionimit dhe zbatimit të KPC-së të ndryshuar. (pz 2021-2025)*

**Institucioni raportues:** Ministria e Drejtësisë

**Informacion mbi zbatimin e masës:**

	<p>Kjo masë shfaqet në çdo rast si “në vazhdimësi”, në kushtet kur zbatimi i Kodit të Procedurës Civile të ndryshuar nuk bëhet nga Departamenti i Përafrimit, Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, por nga gjykatat dhe subjektet e tjera, të cilave u adresohen rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile dhe të mosmarrëveshjeve të tjera të parashikuara në këtë Kod.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Gjatë rishikimit dhe përditësimit të SND-së, mund të merret parasysh edhe kundërshtimi i MD-së lidhur me institucionet përgjegjëse për këtë masë.</p>
2.1.4	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të Kodit të Familjes (KF).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Drejtoria e Përafrimit, Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit është në proces vlerësimi të nevojave për ndërhyrje në Kodin e Familjes, sipas problematikave të evidentuara dhe të paraqitura nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve ose Avokati i Popullit.</p>
2.1.5	<p><i>Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të Kodit të Familjes (KF).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Drejtoria e Përafrimit, Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit ka përgatitur një projektligj paraprak, i cili është në proces vlerësimi sipas analizave të kryera.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Paketa e amendamenteve të nevojshme të KF-së ende nuk është gati. Ekziston risku i vonësës pasi duhet të vlerësohet cdo rekomandim apo gjetje e analizës së kryer.</p>
2.1.6	<p><i>Kryerja e analizës së rishikimit të funksionimit dhe zbatimit të KF-së të ndryshuar.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Ky objektivi do të realizohet pas miratimit të ndryshimeve në Kodin e Familjes.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Ndryshimet përfundimtare varen nga miratimi i Ligjit nga Kuvendi. Zbatimi do të nisë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të KF-së.</p>
2.1.7	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të ligjit “Për gjykatat administrative dhe mosmarrëveshjet administrative”.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Zbatuar në vitin 2021.</p>
2.1.8	<p><i>Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të ligjit “Për gjykatat administrative dhe mosmarrëveshjet administrative”.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p>

	<p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Zbatuar në vitin 2021.</p>
2.1.9	<p><b><i>Kryerja e analizës së rishikimit të funksionimit dhe zbatimit të ligjit “Për gjykatat administrative dhe mosmarrëveshjet administrative”, të ndryshuar.</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Kjo masë paraqitet si në zhvillim e sipër dhe në vijimësi në çdo rast, në kushtet kur zbatimi i ligjit për gjykatat administrative nuk bëhet nga DPKHL (Drejtoria e Përafrimit, Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit), por nga gjykatat dhe subjektet e tjera, të cilëve u drejtohen rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative të parashikuara në këtë ligj.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Gjatë rishikimit dhe përditësimit të SND-së, mund të merret parasysh edhe kundërshtimi i MD-së lidhur me institucionet përgjegjëse për këtë masë.</p>
2.1.10	<p><b><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të akteve nënligjore në lidhje me sistemin gjyqësor (udhëzime/urdhëra) dhe rregullave standarde për funksionimin e gjykatave.</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Gjatë periudhës raportuese KLGJ ka miratuar 7 akte të reja nënligjore.</p> <p>KLGJ ka marrë edhe 4 Vendime për riorganizimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Sfida për KLGJ-në lidhur me Hartën e re Gjyqësore të miratuar në vitin 2022 ka të bëjë me disa aspekte ku nevojiten vendime të Këshillit për riorganizimin e gjykatave, ndarjen e dosjeve, ngritjen e seksioneve, trajnimet e stafit etj. Rregullat standarde për funksionimin e gjykatave të shkallës së parë janë në vlerësim nga Këshilli. Një rol më aktiv pritet nga këshillat dhe kryetarët e gjykatave.</p>
2.1.11	<p><b><i>Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së akteve rregullatore për funksionimin e gjykatave.</i></b> (pz 2021-2022)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Pas miratimit të rregullave standarde të Gjykatës së Lartë, KLGJ miratoi rregullat standarde të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndërkohë që janë në proces rregullat standarde edhe për gjykatat e tjera. Referuar afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit masat si vit i fundit të zbatimit ka vitin 2022, por në periudhën në vijim do të ndërmerren hapat e duhur për të realizuar plotësisht masën.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Si më sipër – masa 2.1.10</p>
2.1.12	<p><b><i>Kryerja e analizës të zbatimit të akteve rregullatore për funksionimin e gjykatave</i></b> (pz 2021-2025).</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p>

	<p>Eshtë zhvilluar Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve ku janë diskutuar analizat vjetore. Janë monitoruar në mënyrë të vazhduar (dhe sipas nevojës) mbledhjet dhe procedurat e zgjedhjes së Zëvendëskryetarëve të rinj nëpër gjykata. Janë monitoruar dhe asistuar në mënyrë të vazhduar (dhe sipas nevojës) gjykatat mbi formimin e duhur të Këshillit të Gjykatës. Është miratuar vendimi dhe ngritur nga KLGJ komisioni i ristrukturimit të Gjykatës së Apelit të Jurisdiksionit të Përgjithshëm.</p>
2.1.13	<p><b><i>Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së akteve nënligjore mbi nëpunësit civilë gjyqësorë.</i></b> (pz 2021-2022)</p> <p><b>Institucioni raportues:</b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b>Informacion mbi zbatimin e masës:</b> Gjatë periudhës së raportimit, KLGJ-ja miratoi Vendimin nr. 558, date 29.12.2022 “Për procedurat disiplinore të kancelarit, keshilltarit dhe ndihmesit ligjor” KLGJ raportoi edhe në lidhje me aktet administrative individuale që kanë të bëjnë me nëpunësit civilë gjyqësorë. Me anë të 7 vendimeve KLGJ-ja, ka vendosur kualifikimin për 2 kancelarë në detyrë në gjykatat e shkallës së parë dhe Apelit të Jurisdiksionit të Përgjithshëm; ndërprerjen e marrëdhënies të punës për 2 kancelarë; dhe përfundimin e shqyrtimit pa vendimmarrje të 3 kancelarëve, 2 për shkak të dorëheqjes dhe 1 për shkak të plotësimit të moshës së daljes në pension“; 12 vendime për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për t’u pranuar në shërbimin gjyqësor civil; dhe 7 vendime për pozicionin e keshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Ndërkohë janë në proces hartimi dhe diskutimi edhe 4 akte të tjera nënligjore përpara miratimit nga KLGJ-ja në seancë plenare.</p>
2.1.14	<p><b><i>Kryerja e analizës të zbatimit të kuadrit ligjor të lidhur me nëpunësit civilë gjyqësorë.</i></b> (pz 2024-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Masa fillon zbatueshmërinë në vitin 2024.</p>

Për OS 2.1 është përcaktuar një tregues performance:

➤ ***% e akteve ligjore dhe nënligjore që i janë nënshtruar analizës së vlerësimit nga organet e gjyqësore.***

Në vitin 2021 janë raportuar se I janë nënshtruar analizës së vlerësimit 19 akte nënligjore. Për vitin 2022 KLGJ ka raportuar se 100% e akteve i janë nënshtruar analizës së vlerësimit, pra targeti është realizuar.

Ndërkohë që treguesi nuk synon të masë progresin në kohë, por më tepër të vlerësojë arritjet për periudhën specifike raportuese, të dhënat e raportuara për vitet 2021 dhe 2022 tregojnë se KLGJ është angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në një analizë të akteve nënligjore me synim përmirësimin e aftësive profesionale, aksesueshmërisë, transparencës, dhe efikasitetit të organeve gjyqësore.



**Pikat kryesore për OS 2.1.**

- Drejtoria e Përafrimit, Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në MD ka zbatuar shumicën e masave të Plani të Veprimit. Megjithatë, ka ende dy masa që kërkojnë përpunimin e analizave për zbatimin e Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit Administrativ tashmë të ndryshuara. Megjithatë, rekomandimi i strukturës përkatëse në lidhje me faktin se institucionet e tjera zbatojnë ligjet e ndryshuara dhe ato duhet të jenë përgjegjëse për këto analiza është e arsyeshme dhe mund të merret në konsideratë gjatë përditësimit të ardhshëm të SND dhe Planit të saj të Veprimit. Këtu duhet theksuar se gjatë periudhës raportuese e njëjta strukturë ka kryer edhe disa detyra të tjera lidhur me ndryshimet e legjislacionit me qëllim harmonizimin e tij me legjislacionin evropian.
- DPKHL (Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit) është në proces vlerësimi të nevojave për ndërhyrje në Kodin e Familjes, sipas problematikave të evidentuara dhe të paraqitura nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve ose Avokati i Popullit.
- Harta e re gjyqësore në Shqipëri e miratuar në vitin 2022 është sfida më e madhe për KLGJ. Sipas vendimeve dhe akteve nënligjore të raportuara, të përpunuara dhe miratuara nga Këshilli në vitin 2022 për lehtësimin e funksionalitetit të Hartës së re Gjyqësore, duhet të konkludohet se tashmë janë bërë hapa dhe KLGJ po tregon kapacitetin dhe gatishmërinë për të përmbushur detyrimet e saj.

## Objektivi Specifik 2.2.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.2 parashikon 6 masa, prej të cilave 5 masa i aplokohen Gjykatës Kushtetuese. Të **peseë (5) masat janë zbatuar plotësisht** (100% e masave janë realizuar plotësisht-- niveli i tolerances “shumë mirë”). Niveli i realizimit të OS 2.2. sipas mesatares së përqindjes së realizimit të masave është 100%.

### OS 2.2: Fuqizimi institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese (GJK), sigurimi i burimeve të përshtatshme dhe funksionimi i saj profesional, në mënyrë transparente dhe efektive.

2.2.1	<p><i>Kryerja e analizës mbi vendet vakante në GJK, hapja e thirrjeve dhe plotësimi i vakancave.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Gjykata Kushtetuese</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Gjatë vitit 2022, në Gjykatën Kushtetuese janë plotësuar tre vende vakante për gjyqtarë.</p>
2.2.2	<p><i>Hartimi, publikimi dhe shpërndarja e raporteve të monitorimit për zbatimin e metodologjisë së re për vlerësimin e nevojave për trajnimet e gjyqtarëve.</i> (pz 2022-2024)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Gjykata Kushtetuese</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> <u>Institucioni i raportuar i kësaj mase do të duhet të jetë ShM dhe këto ndryshime do të bëhen gjatë rishikimit të SND. E njëjta masë është përfshirë për ShM - shikoni më poshtë masën 2.3.3.</u></p>
2.2.3	<p><i>Përmirësimi infrastrukturor /logjistik i Gjykatës Kushtetuese bazuar në gjetjet e analizës.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Gjykata Kushtetuese</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Gjatë vitit 2022 është bërë përmirësimi infrastrukturor/logjistik i Gjykatës Kushtetuese në bazë të buxhetit të miratuar.</p>
2.2.4	<p><i>Kryerja e një studimi dhe specifikimi i kërkesave të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me teknologjinë e</i></p>

	<p><i>informacionit, duke përfshirë regjistrin online dhe menaxhimin e çështjeve, arkivimin elektronik, nevojën për staf të specializuar etj. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b>Institucioni raportues:</b> Gjykata Kushtetuese</p> <p><b>Informacion mbi zbatimin e masës:</b></p> <p>Nevojat e GJK-së për sigurimin e një sistemi elektronik funksional për menaxhimin e çështjeve, përmirësimin e kapaciteteve profesionale të stafit, arkivin elektronik, parashikohen nga Strategjia e GJK-së 2021-2023, fq. 52, objektivi specifik 1.2, si dhe janë detajuar në Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë, fq. 57-58.</p>
2.2.5	<p><i>Blerja e hardëare dhe softëare për Gjykatën Kushtetuese. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b>Institucioni raportues:</b> Gjykata Kushtetuese</p> <p><b>Informacion mbi zbatimin e masës:</b></p> <p>Për vitin 2022 janë blerë vetëm pajisje kompjuterike harduerike (PC, laptop, printera, fotokopjues dhe UPS) në përputhje me buxhetin e miratuar.</p>
2.2.6	<p><i>Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e raporteve të monitorimit të zbatimit të metodologjisë së re për vlerësimin e trajnerëve. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b>Institucioni raportues:</b> Gjykata Kushtetuese</p> <p><b>Informacion mbi zbatimin e masës:</b></p> <p>Njësoj si Masa 2.2.2 – institucioni raportues është SHM, jo GJK. Shikoni masën 2.3.4. më poshtë.</p>

Për OS 2.2 janë përcaktuar dy tregues performance:

- **% e numrit të akteve rregullatore që ka miratuar Gjykata Kushtetuese në zbatim të ligjit të saj**

Vlera e synuar për këtë tregues në vitin 2022 ishte 0 akte. Megjithatë, GJK ka miratuar dy akte rregullatore gjatë këtij viti raportues, përkatësisht Kodin Etik të Gjykatës Kushtetuese dhe Rregulloren për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese publikuar në Fletore Zyrtare nr. 13, 27.01.2022).



- **Raporti i çështjeve të mbartura nga Gjykata Kushtetuese (%)**



Ky tregues mat raportin ndërmjet çështjeve të mbartura në fund të vitit raportues dhe numrit të përgjithshëm të çështjeve në Gjykatën Kushtetuese në atë vit (d.m.th., çështjet e mbartura në fillim të vitit 2022 (dmth. të mbartura nga viti 2021) + çështjet e regjistruara gjatë vitit 2022).

Objektivat e përcaktuara në pasaportën e treguesve synojnë të ulin peshën e çështjeve të mbartura, nga niveli bazë prej 68% në vitin 2020, në 50% në vitin 2022, deri në 30% në vitin 2025.

Në vitin 2022, prej gjithsej 291 çështje (të mbartura nga viti 2021 dhe të reja të regjistruara gjatë vitit 2022), vetëm 85 çështje ishin ende të pazgjidhura në fund të vitit raportues (2022).

Këto përbëjnë 29% të totalit çështjeve të gjykatës në 2022. Treguesi ka trend zbritës, dhe sa më e ulët të jetë përqindja e çështjeve të mbartura në fund të vitit, aq më pozitive është performanca e Gjykatës Kushtetuese. Ndaj në këtë kuptim, GJK e ka tejkaluar targetin (50%) e përcaktuar për vitin 2022, madje edhe atë të përcaktuar për vitin 2025 (30%). Niveli i realizimit të targetit për vitin 2022 është 172.4%.

### Çështjet në Gjykatën Kushtetuese në 2022



### Pikat kryesore për OS 2.2.

- Gjykata Kushtetuese është tashmë funksionale dhe operacionale.
- Në vitin 2022 u plotësuan 3 vende vakante gjyqtarësh në GJK në bazë të propozimeve të KED. Infrastruktura dhe logjistika e Gjykatës Kushtetuese lehtësojnë punën e përditshme të gjyqtarëve dhe personelit mbështetës. Reduktimi i numrit të çështjeve të mbartura është arritur duke tejkaluar edhe objektivin e vitit 2025 të parashikuar në Pasaportën e Indikatorëve,

### Objektivi Specifik 2.3.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.3 parashikon parashikon 15 masa, prej të cilave **12 masa janë zbatuar plotësisht**, dy(2) masa janë zbatuar pjesërisht, dhe **nje (1) masë rezulton e pazbatuar** (86% e masave janë zbatuar plotësisht - niveli i tolerances “shumë mirë”). Niveli i realizimit të OS 2.3. sipas mesatares së përqindjes së zbatimit të masave është 89%.

**OS 2.3: Rritja e efikasitetit dhe aftësisë profesionale të sistemit të trajnimit i cili siguron avancimin drejt praktikave evropiane dhe cilësisë në fushën e drejtësisë duke siguruar një numër të përshtatshëm të magjistratëve dhe këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë të trajnuar për sistemin e drejtësisë në Shqipëri.**

2.3.1

*Kryerja e analizës së përputhshmërisë së metodologjisë për vlerësimin e nevojave për trajnim me standardet evropiane. (pz 2021-2025)*

**Institucioni raportues:** Shkolla e Magjistraturës



	<p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Shkolla e Magjistraturës ndërmori një proces të gjatë analize të ecurisë së punës dhe nevojave për përmirësim në Programin e Formimit Vazhdues, duke u nisur nga kontrolli mbi efikasitetin, praktikitetin dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të metodologjisë së ndjekur për analizën e nevojave për trajnim.</p>
2.3.2	<p><i>Përgatitja e metodologjisë së re për vlerësimin e nevojave për trajnim bazuar në rezultatet e analizës së përputhshmërisë. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Shkolla e Magjistraturës bazuar në konkluzionet e analizës, filloi përgatitjen e metodologjisë së re për analizën e nevojave. Përmirësimet e metodologjisë nuk kishin nevojë për ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Shkollës, por vetëm për përmirësimin e dokumenteve të punës të sektorit të Formimit Vazhdues në SHM.</p>
2.3.3	<p><i>Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e raporteve të monitorimit të zbatimit të metodologjisë së re për vlerësimin e nevojave për trajnimin. (pz 2022-2024)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Sektori i Formimit Vazhdues ka nisur diskutimin për metodologjinë që do të ndiqet në hartimin e raporteve të monitorimit. Gjatë vitit 2022 SHM, në funksion të kësaj mase, ka realizuar të gjitha aktivitetet e nevojshme.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Duke marrë në konsideratë përmbledhjen për masën 2.3.2, duket se kjo masë do të rishikohet në përputhje me rrethanat gjatë rishikimit të SND-së.</p>
2.3.4	<p><i>Kryerja e analizës së përputhshmërisë së metodologjisë për vlerësimin e trajnerëve me standardet evropiane. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>SHM raportoi se Trajnuesit janë përzgjedhur në bazë të meritës dhe në transparencë të plotë, duke i dhënë përparësi rritjes së përfshirjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe duke ndjekur me kujdes procesin për përgatitjen e kurrikulave dhe moduleve të trajnimit nga trajnuesit.</p> <p>SHM i kushton rëndësi të veçantë vlerësimit të trajnerëve dhe e sheh vlerësimin si një mjet për përmirësimin e punës së tij. për këtë arsye, bazuar në metodat e EJTN mbi efektivitetin e trajnimeve, ku një pjesë iu kushtua vlerësimit të ekspertit, SHM ndërmori një analizë të re të metodave të përdorura për vlerësimin e trajnerëve të programit të trajnimit të vazhdueshëm.</p>
2.3.5	<p><i>Përgatitja e metodologjisë së re për vlerësimin e trajnerëve bazuar në rezultatet e analizës së përputhshmërisë. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Metodologjia EJTN ishte një nga mjetet krahasuese që u mor në konsideratë për t'u reflektuar mbi modelet e dakordësuara mes shkollave evropiane homologe. Si rezultat i procesit të analizës me metodologjinë e vlerësimit të ekspertëve, janë bërë disa ndryshime. Sipas ndryshimeve të bëra, mënyrat e vlerësimit të trajnerëve janë më të plota, referenca për vlerësim janë marrë nga më shumë</p>


	burime dhe ofrojnë më shumë garanci për paanshmërinë dhe profesionalizmin e këtij procesi.
2.3.6	<p><i>Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e raporteve të monitorimit të zbatimit të metodologjisë së re për vlerësimin e trajnerëve . (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Përmbledhja e veprimeve:</u></b></p> <p>Spektori i Formimit Vazhdues ka nisur diskutimin për metodologjinë që do të ndiqet në hartimin e raporteve të monitorimit. Gjatë vitit 2022 SHM, në funksion të kësaj mase, ka realizuar të gjitha aktivitetet e nevojshme.</p>
2.3.7	<p><i>Kryerja e analizës së përputhshmërisë së metodologjisë së trajnimit të vazhdueshëm me standardet evropiane. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Shkolla e Magjistraturës ndërmori një proces të gjatë analize të metodologjisë së trajnimeve, në mënyrë që ato të jenë sa më të dobishme për përfituesit e tyre dhe të rrisin cilësinë e gjyqësorit, por nga ana tjetër, të mos sjellin mungesa në gjyqësor në kushtet aktuale kur gjyqësori ka shumë vende të lira.</p>
2.3.8	<p><i>Përgatitja dhe unifikimi i metodologjisë së re për trajnimin e vazhdues bazuar në rezultatet e analizës së përputhshmërisë. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Metodologjia e unifikuar u është njoftuar të gjithë trajnuesve dhe SHM-ja ka zhvilluar gjithashtu trajnime me ekspertë për t'i trajnuar ata në zbatimin e metodologjisë së re.</p>
2.3.9	<p><i>Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e raporteve të monitorimit të zbatimit të metodologjisë së re për trajnimin vazhdues . (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Spektori i Formimit Vazhdues ka nisur diskutimin për metodologjinë që do të ndiqet në hartimin e raporteve të monitorimit mbi zbatimin e metodologjisë së trajnimit. Gjatë vitit 2022 SHM, në funksion të kësaj mase, ka realizuar të gjitha aktivitetet e nevojshme.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Masat nën 2.3.14 dhe 2.3.15 janë përsëritje e kësaj mase. Gjatë procesit të rishikimit të SND ky fakt do të merret në konsideratë.</p>
2.3.10	<p><i>Kryerja e analizës për nevojën për rishikim të programeve të trajnimit vazhdues. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Shkolla e Magjistraturës ndërmori një proces të gjatë të analizës së nevojave për rishikimin e programeve me qëllim trajnimin në sistemin e drejtësisë dhe lehtësimin e punës së tij në kushtet aktuale të sistemit të drejtësisë. Programi i formimit Vazhdues është përditësuar, veçanërisht në lidhje me cilësinë e kurrikulës dhe të trajnuesve. SHM ka organizuar trajnime të veçanta, bazuar në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së.</p>
2.3.11	<p><i>Përgatitja e programeve të formimit vazhdues në përputhje me standardet evropiane. (pz 2022-2022)</i></p>

	<p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Përmbledhja e veprimeve:</u></b></p> <p>Shkolla e Magjistraturës ka hartuar Programin e Formimit Vazhdues në përputhje me ligjin, rregulloret e brendshme dhe standardet ndërkombëtare në fushën e trajnimit.</p>
2.3.12	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të ligjit “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloret e saj.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë; Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Kërkesa për ndryshime ligjore u paraqit në Kuvend gjate vitit 2021. Për periudhat raporutese të ardhmshme do të raportojë edhe mbi propozime të tjera që do të bëhen nga SHM.</p>
2.3.13	<p><i>Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të ligjit “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloret e saj.</i> (pz 2022-2022)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Nuk ka zhvillime.</p>
2.3.14	<p><i>Përgatitja dhe miratimi i metodologjisë së studimeve dhe botimeve të Shkollës së Magjistraturës në përputhje me standardet evropiane.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>SHM po merr masa për ridimensionimin e procesit të studimeve dhe publikimeve me qëllim mirjen e produkteve të SHM në këtë drejtim. SHM ka bërë ndryshime në rregulloren e publikimeve dhe ka shtuar stafin administrativ dhe akademik që ndjek këtë proces. SHM zbaton rregullat për miratimin e kërkesave për botim të miratuara në vitin 2021. Gjithashtu është hapur një pozicion i ri pune si “Këshilltar për Botimet dhe Botimet Shkencore”, i cili do të ndjekë strategjinë e zhvillimit të Sektorit të Studimeve dhe Botimeve Shkencore, do të vijojë veprimtarinë shkencore të Shkollës dhe do të promovojë e përfshijë projekte për tekste dhe botime shkencore në Shkollë.</p>
2.3.15	<p><i>Krijimi i bazës së të dhënave të lektorëve dhe trajnerëve të Shkollës së Magjistraturës, që kanë njohuri mbi ligjin e BE-së.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Përmbledhja e veprimeve:</u></b></p> <p>Është krijuar një bazë të dhënash me pedagogë dhe trajnues të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë njohuri mbi të drejtën e BE. Është kryer identifikimi sasior i numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve që do të trajnohen në lidhje me legjislacionin dhe standardet e BE dhe praktikën ndërkombëtare.</p>

Për OS 2.3 është përcaktuar një tregues performance:

➤ **Kuotat vjetore të kandidatëve magjistratë, këshilltarëve dhe ndihmësve në Shkollën e Magjistraturës**

Vlerat e synuara të treguesit për vitin 2022 janë si më poshtë: 100 kandidatë nga KLGJ dhe 30 kandidatë nga KLP. Për vitin akademik 2022-2023 në Shkollën e Magjistraturës, KLGJ-ja miratoi një kuotë prej 55 kandidatësh (40 kandidatë gjyqtarë dhe 15 kandidatë ndihmës ligjorë) dhe KLP 35 kandidatë.



Edhe pse kuota e miratuar nga KLGJ për vitin 2022 është më e ulët sesa targeti, duhet theksuar se vendimi është marrë pas një analize të vlerësimit të nevojave nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës së KLGJ dhe është miratuar në seancë plenare. Kuota maksimale e kandidatëve për gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë u përcaktua në bazë të faktorëve të tillë si status quo-ja e gjyqësorit dhe nevojat e lidhura me to (përsa i përket transferimeve, pozicioneve vakante, gjyqtarëve të sapodiplomuar nga SHM, etj.), ndikimi i procesi të vettting-ut në gjyqësor dhe kapacitetet e SHM në lidhje me ofrimin e kurseve për trajnimin fillestar. Në analizë bëhet edhe një vlerësim i numrit të gjyqtarëve që do t'i bashkohen sistemit në vitet e ardhshme. Raportohet se 28 gjyqtarë të rinj do të hyjnë në sistem në vitin 2022, 40 gjyqtarë të rinj në vitin 2024 dhe 35 gjyqtarë në vitin 2025, pas diplomimit në SHM.

Vlerësimi i Këshillit u bazua gjithashtu në një analizë simuluese të kryer nga një projekt asistence, analizë e cila synon të përcaktojë se kur numri i gjyqtarëve do të arrijë të njëjtin nivel si përpara procesit të rivlerësimit kalimtar (408 gjyqtarë). Një skenar i parë simulues rapashikon se nëse 28 deri në 40 gjyqtarë të rinj do të hyjnë në sistem çdo vit pas vitit 2025 (d.m.th. viti i diplomimit të kandidatëve që fillojnë trajnimin e tyre fillestar në vitin 2022), objektivi (408 gjyqtarë) nuk mund të arrihet përpara viteve 2029-2032. Në një skenar të dytë, nëse SHM arrin të trajnojë nga 56 deri në 80 gjyqtarë të rinj çdo vit, objektivi pritët të arrihet në vitin 2027.

### Pikat kryesore për OS 2.3.

- Shkolla e Magjistraturës ndërmori një proces të gjatë analize të ecurisë së punës dhe nevojave për përmirësim në Programin e Formimit Vazhdues. Në bazë të konkluzioneve të analizës, Shkolla e Magjistraturës nisi përgatitjen e Metodologjisë së re.
- Shkolla e Magjistraturës hartoi Programin e Formimit Vazhdues në përputhje me ligjin, rregulloret e brendshme dhe standardet ndërkombëtare në fushën e trajnimit.
- Është krijuar një bazë të dhënash me pedagogë dhe trajnues të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë njohuri mbi ligjin e BE-së.
- Gjatë procesit të përditësimit të SND-së vëmendje e veçantë do t'i kushtohet Programit të Formimit Fillestar për grupe të ndryshme të synuara dhe synimeve strategjike përkatëse.

## Objektivi Specifik 2.4.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.4 parashikon 9 masa, prej të cilave një masë (masa 2.4.5) ka zbatueshmëri në periudhën 2024-2025.

Nga 8 masat që kanë filluar zbatueshmërinë në periudhën 2021-2022, **5 masa janë zbatuar plotësisht** dhe **3 masa janë zbatuar pjesërisht** (63% e masave janë zbatuar plotësisht - niveli i tolerances “mirë”). Niveli i realizimit të OS 2.4. sipas mesatares së përqindjes së zbatimit të masave është 90%.

<b>OS 2.4: Përmirësimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë GJL-në, dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët.</b>	
2.4.1	<p><i>Përgatitja dhe miratimi i studimeve të fizibilitetit të infrastrukturës së gjykatave.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Parashikohet në Planin Strategjik të KLGJ-së që do të zbatohet në vitin 2023 sepse zbatimin e Hartës së re Gjyqësore fillon në 1 Shkurt 2023 dhe është e përcaktuar të ndjekë 3 faza gjatë zbatimit të saj. Konkretisht faza e parë ka të bëjë me bashkimin e gjykatave të apeleve në një gjykatë apeli me juridiksion të përgjithshëm e cila filloi në 01.02.2023. Faza e dytë e zbatimit të hartës do të përfshijë bashkimin e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe propozohet të fillojë në dt. 01.04.2023 dhe faza e tretë, bashkimin e gjykatave administrative të shkallës së parë që do të bëhet i mundur në dt.01.06.2023. Për këtë arsye ky aktivitet është parashikuar për vitin 2023.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>KLGG-ja ka qenë e mbingarkuar me aktivitete që lidhen me zbatimin e hartës së re gjyqësore në vitin 2022.</p>
2.4.2	<p><i>Kryerja e vlerësimeve të qëndrueshme, të pavarura dhe gjithëpërfshirëse të gjykatave, për të matur performancën kundrejt standardeve të përcaktuara.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Në zbatim të vendimit nr. 25, datë 07.02.2019, KLGJ-ja ka realizuar 2 raporte 3-mujore për nxjerrjen e statistikave dhe analizave të performancës së gjykatave. Gjithashtu, Këshilli në fillim të çdo viti, për vitin paraardhës raporton në Raportin Vjetor të performancës së gjykatave në lidhje me standardet e vendosura.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Ka ende hapësirë për krijimin e një sistemi të ri standardesh për matjen e performancës së gjykatës bazuar në të dhënat statistikore. Harta e re Gjyqësore dhe standardet CEPEJ do të merren në konsideratë.</p>
2.4.3	<p><i>Kryerja e analizës mbi nivelin e zbatimit të standardeve, kodit të etikës dhe raportimi publik mbi gjetjet.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>KLGG-ja ka realizuar Raportin Vjetor të analizës së sistemit gjyqësor, i cili raportohet një herë në vit.</p>

	Këshilltari i Etikës raporton në KLGJ çdo vit. KLGJ-ja miratoi raportin vjetor të veprimtarisë së Këshilltarit të Etikës për vitin 2021 me vendimin nr. 5, datë 08.02.2022.
2.4.4	<p><b><i>Miratimi dhe zbatimi i hartes së re gjyqësore.</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Harta e Re Gjyqësore u finalizua me vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 495, datë 21.07.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencat gjyqësore të gjykatave”, nëpërmjet të cilit u vendos riorganizimi në 13 (trembëdhjetë) gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, 2 (dy) gjykata administrative të shkallës së parë dhe 1 (një) gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm, duke përcaktuar kompetencat e tyre territoriale. KLGJ-ja ka miratuar 4 Vendime lidhur me hartën Gjyqësore.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Zbatimi i Hartës së re Gjyqësore kërkon shumë burime dhe bashkëpunim të shkëlqyer mes KLGJ-së dhe gjykatave.</p>
2.4.5	<p><b><i>Ndërtimi i godinës së re të Gjykatës së Apelit, Tiranë, dhe ngritja e kapaciteteve të stafit të gjykatave.</i></b> (pz 2024-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Përmbledhja e veprimeve:</u></b></p> <p>Ndonëse periudha e zbatimit për këtë masë është 2024-2025, KLGJ ka kryer hapa paraprakë për zbatimin gradual të masës. Gjatë periudhës raportuese, KLGJ-ja ka marrë 3 vendime në lidhje me Gjykatën e Apelit. Aktualisht po vazhdon puna për përcaktimin e normave standarde për organogramën, duke përshkruar detyrat dhe përgjegjësitë për çdo kategori punonjësish. Autoritetet kombëtare ende nuk janë ende të vendosura për godinën e re të Gjykatës së Apelit.</p>
2.4.6	<p><b><i>Kryerja e analizës dhe përgatitja e raporteve të monitorimit mbi zbatimin e dokumenteve strategjike të komunikimit nga KLGJ-ja.</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Me vendimin nr. 454, datë 02.11.2022, KLGJ ka miratuar planin e komunikimit për gjykatat.</p>
2.4.7	<p><b><i>Ëorkshop-e/tryeza teknike periodike me titullarët e institucioneve (KLGJ/KLP/PP), për rritje të bashkëpunimit ndërinstitucional.</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Në kuadër të hartimit dhe konsolidimit të dokumentit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, Ministria e Drejtësisë vlerësoi se përfshirja e institucioneve të reja të drejtësisë do të ndikonte në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe do të angazhohej në çdo proces vendimmarrjeje në përgjithësi, si dhe në veçanti në atë të Reformës në Drejtësi. Ka disa nisma të MD-së që synojnë rritjen e bashkëpunimit me institucionet e pavarura.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Vullneti për bashkëpunim i të gjithë pjesëmarrësve në këtë proces është vendimtar.</p>
2.4.8	<p><b><i>Krijimi i infrastrukturës për të ngritur një njësi për pritjen e publikut pranë ILD-së.</i></b> (pz 2021-2025)</p>


	<p><b>Institucioni raportues:</b> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><b>Informacion mbi zbatimin e masës:</b></p> <p>Sektori i Ankesave dhe Ndihmës Juridike ka pritur çdo qytetar që i është drejtuar ambienteve të institucionit, konkretisht gjatë vitit 2022 në ambientet e institucionit janë zhvilluar 246 takime me qytetarë si dhe 296 sqarime, orientime dhe shpjegime nëpërmjet numrit të telefonit të dedikuar për këtë qëllim.</p>
2.4.9	<p><b>Ngritja e kapaciteteve të ILD-së për ofrimin e ndihmës/këshillime me publikun për plotësimin e formularit të ankesave.</b> (pz 2021-2025)</p> <p><b>Institucioni raportues:</b> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><b>Informacion mbi zbatimin e masës:</b></p> <p>Sektori i Ankesave dhe Ndihmës Juridike gjatë viteve të mëparshme ka kryer trajnimet e nevojshme të ofruara nga ASPA për t'u ofruar asistencë apo këshilla qytetarëve që vijnë pranë institucionit për të plotësuar formularin e ankesës. Formulari i ankesës është publikuar në faqen e ILD-së. Është publikuar edhe udhëzimi për qytetarët se si të plotësojnë formularin e ankesës.</p> <p>Programi për informim dhe komunikim me publikun i Zyrës së ILD-së është miratuar dhe në proces zbatimi.</p> <p>Faqja zyrtare <a href="http://www.ild.al">www.ild.al</a> ofron akses në informacione në kohë reale, në shqip dhe në anglisht, si dhe përmbush detyrimet e përcaktuara në "Ligjin për Qeverisjen" nr. 115/2016 dhe Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Nëpërmjet faqes së internetit, ILD-ja ka krijuar marrëdhënie proaktive, transparente dhe informuese me publikun dhe median, ndjekur nga ankesat në ILD, që në fazën fillestare të shqyrtimit derisa të përfundojë në vendimmarrje.</p>

Për O.S 2.4 janë përcaktuar tre tregues performance:

➤ **% e zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të një çështje penale (vlera të ndara për shkallën e parë dhe shkallën e apelit, vetëm juridiksion i përgjithshëm)**

Kohëzgjatja mesatare e çështjeve është një tregues kryesor i efikasitetit të gjykatës dhe ndikon drejtpërdrejt (edhe pse nuk është faktori i vetëm) në aksesin efektiv në drejtësi. Objektivat matëse të përcaktuara në pasaportën e treguesve (si për vitin 2021, ashtu edhe për vitin 2022) janë 70 ditë për çështjet penale në shkallë të parë dhe 260 ditë për çështjet penale në shkallën e apelit.

Sipas metodologjisë për llogaritjen e treguesit, siç përcaktohet në pasaportën e indikatorëve, duhet të raportohet kohëzgjatja mesatare reale e çështjeve, pra shuma e kohëzgjatjes të të gjitha çështjeve (gjatë vitit raportues) pjesëtuar me numrin e çështjeve. Megjithatë, për shkak të mungesës së funksionimit të duhur të CMS (Sistemit të Menaxhimit të



Çështjeve) në gjykata, të dhënat përkatëse duhet të mblidhen manualisht, gjë që rezulton e veshtirë për t'u realizuar në praktikë, dhe karakterizohet nga një risk i lartë pasaktësie. Rrjedhimisht, KLGJ-ja raporton kohën e llogaritur të zgjidhjes (DT) së çështjeve, e cila mat kohën teorike të nevojshme për zgjidhjen e një çështjeje të mbartur, duke marrë parasysh numrin e çështjeve të zgjidhura gjatë vitit dhe numrin total të çështjeve të mbartura në vitin pasardhës (indikator i zhvilluar nga CEPEJ).<sup>13</sup>

Objektivat e përcaktuara në pasaportën e treguesve synojnë të ulin në mënyrë progresive kohën e nevojshme për zgjidhjen e çështjeve të mbartura. Treguesi ka trend zbritës, dhe sa më e ulët të jetë koha e nevojshme për zgjidhjen e çështjeve të mbartura, aq më pozitive është performanca e Gjykatës. Për vitin 2021 KLGJ raportoi një DT prej 68 ditësh (d.m.th., periudhë më e shkurtër se ajo e përcaktuar nga targeti (70 ditë)) për çështjet penale në shkallë të parë, dhe 361dd (d.m.th., periudhë më e gjatë se ajo e përcaktuar në target) për çështjet penale në shkallën e apelit. Të dhënat për vitin 2022 tregojnë se, për shkallën e parë DT për çështjet penale është 98 dhe për apelin DT për çështjet penale është 407.4 ditë. Treguesi mesatar i kohës se nevojshme për zgjidhjen e një çështjeje të shprehur në ditë (treguesi DT) për çështjet penale për vitin 2022 rezulton me një rritje apo zgjatje të afatit kohor për zgjidhjen e çështjes me 13% krahasuar me vitin 2021 në nivel apeli. Ky ndryshim rezulton për mesataren e treguesit DT në të gjitha gjykatat e apelit dhe ndikohen nga zgjatja e kohës se nevojshme në gjykata me ngarkesë të lartë si ajo e Apelit Tirane. Pavarësisht zgjatjes së kohës se nevojshme, kohet e gjykimit të çështjeve penale në nivel apeli respektojnë afatet e arsyeshme ligjore. Për shkallët e para ndryshimi i mesatares së treguesit DT është rritur me 44% ose 30 ditë më shumë. Pavarësisht rritjes mesatare mbetet në vlerat e afatit të arsyeshëm ligjor.




- **% e zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të çështjes civile në shkallën e parë dhe në apel (vlera të ndara për secilin nivel)**

<sup>13</sup> Formula për llogaritjen e DT është:  $DT = \frac{\text{Numri i çështjeve të mbartura në fund të periudhës raportuese}}{\text{Numri i çështjeve të zgjidhura në këtë periudhë}} \times 365$



Në mënyrë të ngjashme me indikatorin e mëparshëm, objektivat e përcaktuara në pasaportën e indikatorëve, si për vitin 2021, ashtu edhe për vitin 2022 janë të njëjta. Për çështjet civile, targeti i caktuar është 198 ditë në shkallë të parë dhe 1600 ditë në shkallë apeli. Gjithashtu, siç shpjegohet në lidhje me treguesin për çështjet penale, KLGJ-ja raporton Kohën e Llogaritur të Zgjidhjes (DT) së çështjeve, e cila mat kohën teorike të nevojshme për zgjidhjen e një çështjeje të mbartur duke pasur parasysh numrin e çështjeve të zgjidhura gjatë vitit dhe numrin total të çështjeve të mbartura në vitin pasardhës (tregues i zhvilluar nga CEPEJ).

### DT: Çështje civile



Të dhënat për vitin 2022 tregojnë se, për shkallën e parë DT për çështjet civile është 168 ditë dhe DT për çështjet civile në apel është 1606 ditë. Treguesi mesatar i kohës së nevojshme për zgjidhjen e një çështjeje të shprehur në ditë (treguesi DT) për çështjet civile për vitin 2022 rezulton me një rritje apo zgjatje të afatit kohor për zgjidhjen e çështjes me 13% krahasuar me vitin 2021 në nivel apeli. Ky ndryshim rezulton për mesataren e treguesit DT në të gjitha gjykatat e apelit dhe ndikohen nga zgjatja e kohës së nevojshme në gjykata me ngarkesë të lartë si ajo e Apelit Tirane.

Për shkallët e para ndryshimi i mesatares së treguesit DT është rritur me 40% ose 48 ditë më shumë. Pavarësisht rritjes mesatare mbetet në vlerat e afatit të arsyeshëm ligjor.



- **% e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni bazë është në dispozicion në internet dhe i përditësuar.**

KLJGJ ka raportuar, si për vitin 2021, ashtu edhe për vitin 2022, se për 100% të çështjeve gjyqësore informacioni bazë është i disponueshëm online dhe i përditësuar. Këto informacione mund të aksesohen nga platforma virtuale ([www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al)) nga palët dhe përfaqësuesit e tyre. Faqja e internetit përmban gjithashtu një video ilustruese se si mund të kërkohet në faqe për të marrë informacionin e kërkuar. Në këtë mënyrë, targeti është arritur plotësisht.



#### Pikat kryesore për OS 2.4.

- Miratohet Harta e Re Gjyqësore dhe zbatimi i saj filloi në vitin 2022.
- KLGJ-ja është e përfshirë plotësisht në përpunimin dhe miratimin e rregullave dhe procedurave në lidhje me Hartën e re Gjyqësore dhe i ka kryer detyrimet e saj me përgjegjësi të lartë.
- KLGJ miratoi Planin e Komunikimit për Gjykatat në Nëntor 2022 dhe filloi zbatimin e tij.. Nisma siguron një akses të lehtë në drejtësi dhe transparencë. Plani i komunikimit është miratuar dhe është në proces zbatimi. Faqja zyrtare e internetit menaxhohet çdo ditë dhe ofron informacion të mjaftueshëm që garanton transparencën e institucionit.
- Ekziston ende një hapësirë për krijimin e një sistemi të ri standardesh për matjen e performancës së gjykatës bazuar në të dhënat statistikore. Do të merren parasysh Harta e re Gjyqësore dhe standardet CEPEJ.
- U vu re se OS 2.4. parashikon edhe GJL-në, por asnjë masë e parashikuar në Planin e Veprimit ku GJL është institucioni përgjegjës. Kjo do të ndryshohet gjatë përditësimit të ardhshëm. Gjithsesi këtu duhet theksuar se GJL funksionon dhe KLGJ ka plotësuar disa nga pozicionet e gjyqtarëve në GJL duke aplikuar procedurën e ngritjes në detyrë.
- Nisma siguron një akses të lehtë në drejtësi dhe transparencë. Plani i komunikimit është miratuar dhe është në proces zbatimi. Faqja zyrtare e internetit menaxhohet çdo ditë dhe ofron shumë informacione që garantojnë transparencën e institucionit.

#### Objektivi Specifik 2.5.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.5 parashikon 17 masa, prej të cilave 4 masa (masat 2.5.1, 2.5.3, 2.5.5 dhe 2.5.7) fillojnë zbatueshmërinë në vitin 2024.

Nga 13 masat që kanë filluar zbatueshmërinë në periudhën 2021-2022, **10 masa janë zbatuar plotësisht**, **3 masa janë zbatuar pjesërisht** (77% e masave janë zbatuar plotësisht - niveli i tolerancës “mirë”). Niveli i realizimit të OS 2.5. sipas mesatares së përqindjes së zbatimit të masave është 87%.

**OS 2.5: Aksesi efikas në drejtësi i siguar nëpërmjet ndihmës juridike, zgjidhjes**

**alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave gjyqësore të përshtatshme.**

2.5.1	<p><b><i>Informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve të ligjit “Për ndihmën juridike falas” për të drejtat e tyre për ndihmë dhe akses në institucione, të cilat mund të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre.</i></b> (pz maj 2024 - qershor 2024)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas administron faqen zyrtare të internetit. Për vitin 2022 janë zhvilluar 286 takime/aktivitete të përbashkëta sensibilizuese ndërmjet ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve të nivelit vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura; 8 intervista televizive/radio janë realizuar në televizionin kombëtar/vendor nga Drejtoria dhe Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.</p> <p>Drejtoria harton dhe publikon edhe Buletinin Mujor (newsletter).</p>
2.5.2	<p><b><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të DNJF-së dhe hartimi i planit/kurrikulave/ programeve të trajnimit.</i></b> (pz 2021-2021)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>DNJF ka bërë një analizë të detajuar për vlerësimin e nevojave mbi forcimin e kapaciteteve të BNJ dhe ka hartuar një plan trajnimi bazuar në rezultatet e kësaj analize. Trajnimi i stafit është kryer në përputhje me specifikat e çdo drejtorie përkatëse.</p>
2.5.3	<p><b><i>Trajnimi i punonjësve të DNJF në kuadër të forcimit të kapaciteteve të për kryerjen e funksioneve të caktuara nga kuadri ligjor për ndihmën juridike.</i></b> (pz 2024-2024)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>DNJF ka zhvilluar disa aktivitete si një hap me rëndësi në rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore.</p> <p>Gjithashtu, me qëllim asistimin e avokatëve në procesin e dhënies së ndihmës juridike dytësore, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.</p> <p>Trajnimi i Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore mbi legjislacionin për refugjatët dhe azilkërkuesit u zhvillua me mbështetjen e Caritas-it Shqiptar në korrik të vitit 2022.</p>
2.5.4	<p><b><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të ofruesve të Ndhmës Juridike parësore dhe hartimi i planit/kurrikulës/ programit të trajnimit.</i></b> (pz 2021-2021)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>DNJF ka kryer një analizë të detajuar mbi vlerësimin e nevojës për trajnimin e ofruesve të ndihmës juridike parësore dhe ka bashkëpunuar me Departamentin e Administratës Publike, ASPA dhe DASH për të kryer 2 trajnime të detyrueshme për punonjësit dhe i trajnim Vazhdues.</p>
2.5.5	<p><b><i>Trajnimi i ofruesve të ndihmës juridike parësore në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar.</i></b> (pz 2024-2024)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>DNJF përfundoi trajnimin e detyrueshëm të punonjësve me trajnim special të rekrutuar në bashkëpunim me</p>

	UNDP/ADPA në dhjetor 2022.
2.5.6	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të avokatëve për ofrimin e ndihmës juridike dytësore falas dhe hartimi i planit/kurrikulës/programit të trajnimit.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>DNJF ka kryer analizën e detajuar për vlerësimin e nevojës për trajnimin e ofruesve të ndihmës juridike dytësore pasi numri i avokatëve që kanë nënshkruar kontratën për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore për vitin 2021 është dyfishuar, duke arritur në 124 avokatë.</p> <p>Trajnimi i dedikuar për ndihmën juridike dytësore është zhvilluar duke iu referuar ekspertizës për secilën nga kategoritë e veçanta të parashikuara në ligj.</p> <p>Ky trajnim u zhvillua si rezultat i një bashkëpunimi midis UNDP, ADA, DHAS, MD dhe DNJF .</p>
2.5.7	<p><i>Trajnimi i avokatëve në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike falas të ofruar.</i> (pz 2024-2024)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Në vitin 2022 janë zhvilluar 2 trajnime për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në DHVA Pogradec/Elbasan dhe Korçë.</p>
2.5.8	<p><i>Krijimi i forumit të bashkëpunimit të DNJF-së me grupe të tjera të interesit në sektorin gjyqësor dhe përgatitja e planit për funksionimin dhe zhvillimin e tij.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>DNJF tashmë ka krijuar një bashkëpunim të mirë me aktorë të ndryshëm në sektorin gjyqësor që kanë detyrime në lidhje me ndihmën juridike.</p>
2.5.9	<p><i>Hartimi, konsultimi dhe miratimi i planit të komunikimit të DNJF-së me grupet e tjera të interesit në sektorin gjyqësor.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Zbatuar në vitin 2021.</p>
2.5.10	<p><i>Kryerja e analizës për praktikën më të mira evropiane në përdorim të mekanizmave për zgjidhjen alternative dhe përgatitja e propozimeve për zbatim në Shqipëri.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Analiza është kryer në disa fusha:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studim pas analize sipas praktikës evropiane në fushën e Familjes. Po hartohet materiali për ndryshimet në Kodin e Familjes.</li> <li>2. Çështjet e pasurisë</li> </ol> <p>Ka ende fusha ku do të bëhen analiza krahasuese dhe propozime përkatëse për amendamentet e ligjit.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Mungesa e ekspertëve që merren me analizat, përmbajtjen e analizave dhe propozimet e arsyeshme për amendamentet e ligjit, mund të jenë risk për hapat e mëtejshëm në zbatimin e kësaj mase. Kështu, një mbështetje nga donatorët për Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve do të ishte e dobishme dhe</p>

	mund të zbuste riskun.
2.5.11	<p><i>Kryerja e ndërhyrjeve në ligjet ekzistuese për përfshirjen e mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe hartimi i planeve të implementimit të tyre.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Miratimi i Statutit të ri të DHKN-së dhe Projekt-Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë të Financave dhe Manuali i Tarifave janë parakushte të rëndësishme për masat organizative të DHKN-së, të cilat do të lehtësojnë ndërhyrjen në ligjet ekzistuese.</p> <p><b><u>Risqet dhe veprimet zbutëse:</u></b> Zbatimi i kësaj mase kërkon bashkëpunim me strukturat përkatëse dhe mbështetjen e donatorëve.</p>
2.5.12	<p><i>Zbatimi i sistemeve të mekanizmave alternativë të mosmarrëveshjeve dhe kryerja e analizës.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/ Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit.</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Është hartuar Drafti i Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Financave për Manualin e Tarifave.</p> <p><b>Risku dhe hapat në vijim:</b> Konsolidimi dhe miratimi i draft udhëzimit.</p>
2.5.13	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të ndërmjetësve/ hartimi planit/kurrikulës/ programit të trajnimit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Zbatuar në vitin 2021</p>
2.5.14	<p><i>Trajnimi i ndërmjetësve në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimit të ndërmjetësimit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Gjatë vitit 2022 janë dhënë 247 licenca. Janë trajnuar 89 kandidatë për t'u licencuar. Për formimin e vazhduar të detyrueshëm janë trajnuar 27 ndërmjetës.</p>
2.5.15	<p><i>Përgatitja e një studimi në lidhje me përditësimin e tarifave gjyqësore duke përllogaritur tabelën e re të kostove me hartën e re gjyqësore dhe zbatimi i saj për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe ZAM.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Në lidhje me këtë masë KLGJ ka marrë vendimin nr.641, datë 23.12.2020 “Mbi propozimin për llojet dhe masat e tarifave gjyqësore dhe procedurën e mbledhjes së tyre”. Ky vendim është përcjellë për miratim pranë Ministrisë së Drejtësisë.</p>
2.5.16	<p><i>Sigurimi i mjediseve, infrastrukturës, pajisjeve, mjeteve të transportit, të mjaftueshme dhe të përshtatshme, dhe mbështetje të qëndrueshme buxhetore për funksionimin efektiv të sistemit të DNJF-së.</i> (pz 2021-2025)</p>

	<p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Zbatuar në vitin 2021.</p>
2.5.17	<p><b><u>Sigurimi i burimeve të përshtatshme për operatorët dytësorë DNJF.</u></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Pagesa e avokatëve për ofrimin e ndihmës dytësore është objektivi kryesor i DNJF-së.</p>



Për OS 2.5 janë përcaktuar 2 tregues performance:

➤ **% e aplikimeve të pranuar për marrjen e ndihmës juridike parësore falas.**

Ndihma juridike falas e garantuar nga shteti është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi. Format, kushtet, procedurat dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti përcaktohen në Ligjin për Ndihmën Juridike të miratuar në vitin 2017. Ndihma Juridike Parësore falas përfshin konsulencë ligjore dhe mbështetje jashtë gjykatës dhe i jepet personat me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme, si dhe grupeve të veçanta të përfituesve vulnerabël (viktima; fëmijë; persona të tjerë të cenueshëm). Në vitin 2022, ndihma juridike parësore u ofrua nga 12 qendra të shërbimit parësor të ndihmës juridike në të gjithë Shqipërinë; 15 që ushtrojnë veprimtarinë në Tiranë, Vlorë, Berat, Elbasan, Shkodër; dhe 12 Klinika Ligjore që ushtrojnë veprimtarinë në Tiranë, Durrës, Shkodër.

Vlera bazë për vitin 2020 për këtë tregues (aplikimet e pranuar për marrjen e ndihmës juridike parësore falas) ishte 4200 persona. Targetet vjetore në pasaportën e indikatorëve synojnë një rritje prej 5% të numrit të përfituesve çdo vit. Targeti është realizuar dhe tejkaluar në vitin 2021 si edhe në vitin 2022.

**Personat që kanë përfituar ndihmë parësore juridike falas**




## ➤ % e aplikimeve të pranuar për marrjen e ndihmës juridike dytësore falas

Ndihma juridike dytësore përfshin përfaqësimin nga një avokat në një procedurë gjyqësore dhe përjashtimin nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore dhe u jepet personave me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme, si dhe grupeve të veçanta të përfituesve të cenueshëm (viktima; fëmijë; persona të tjerë të cenueshëm). Ndihma juridike dytësore ofrohet nga avokatë të përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë me kërkesë të personit që ka të drejtë të përfitojë ndihmë juridike dytësore. Kërkesa i drejtohet gjykatës kompetente.

Vlera bazë për vitin 2020 për këtë tregues (aplikimet e pranuar për marrjen e ndihmës juridike dytësore falas) ishte 157 persona. Objektivat vjetore në pasaportën e indikatorëve synojnë rritjen e numrit të përfituesve me 15% çdo vit (krahasuar me një vit më parë). Objektivat për ndihmën juridike dytësore janë arritur dhe janë tejkuluar në vitin 2021 si edhe në vitin 2022.

### Personat që kanë përfituar ndihmë dytësore juridike falas



### Targeti 2022



### Pikat kryesore për OS 2. 5.

- *Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas* ka arritur rezultate të shkëlqyera në vitin 2022 dhe ka zbatuar të gjitha masat e Planit të Veprimit ku Drejtoria është institucioni përgjegjës. Gjithashtu ka tejkuluar shumë vlerat e synuara si për ndihmën juridike parësore, ashtu edhe për atë dytësore.
- Takimet e përbashkëta, uebsajti, buletini, publikimet, ndërgjegjësimi i publikut, shpërndarja dhe publikimi i materialeve të vizibilitetit, etj. promovon ndihmën juridike në drejtimin më të mirë.
- Disa trajnime, të renditura në planin e veprimit, janë organizuar me sukses me mbështetjen e programeve të donatorëve.
- Është miratuar statuti i ri i *Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve*.
- Në vitin 2022 janë dhënë 247 licenca. Gjithashtu, 89 kandidatë janë trajnuar për t'u licencuar.. 27 ndërmjetës kanë marrë pjesë në trajnimin e formimit të vazhduar, i cili është i detyrueshëm.
- Nevojitet mbështetja e donatorëve për DHKN-në.

### 3.2.3 Qëllimi i Tretë i Politikës


*Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit.*

Për sa i përket arritjes së Qëllimit të tretë të Politikës, gjatë periudhës raportuese, janë zbatuar pjesërisht të katër objektivat specifike që lidhen me këtë qëllim politike. Nga 64 masat e lidhura me këtë qëllim, 53 masa kanë filluar zbatueshmërinë në periudhën 2021-2022. Prej këtyre, **29 masa janë zbatuar plotësisht**, **20 masa janë zbatuar pjesërisht** dhe **4 masa janë të pazbatuara**.

Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (**të zbatuara plotësisht/të zbatuara pjesërisht/të pazbatuara**). Masat të cilat fillojnë periudhën e zbatueshmërisë pas vitit 2022 janë prezantuar me sfond të bardhë.

#### Qëllimi i Tretë i Politikës

#### 53 MASA TË ZBATUESHME NË 2021-2022



Është parashikuar një tregues në nivelin e Qëllimit të Tretë të Politikës:

- **% të ankesave të personave që vuajnë dënimin në IEVP lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut**

Treguesi në nivelin e Qëllimit të Politikës synon të masë ndikimin e institucioneve që ekzekutojnë dënime penale dhe respektimin prej tyre të të drejtave dhe lirive themelore të personave të dënuar që vuajnë dënime pranë këtyre institucioneve (IEVP) – përqindja e ankesave duhet të jetë në rënie. Vlera bazë e targetit për vitin 2020 e vendosur në pasaportën e treguesve ishte 62% dhe vlera e synuar e vitit 2022 është 50%.


Institucionet përkatëse kanë evidentuar mungesën e një shpjegimi të detajuar në pasaportën e treguesve mbi mënyrën e identifikimit “të ankesave lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut”, duke theksuar se elementë të lidhur me të drejtat e njeriut mund të jenë të pranishëm në çdo kërkesë. Për këto arsye është raportuar numri total i ankesave të paraqitura në IEVP-të dhe në



Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB).

Prezantimi grafik i të dhënave tregon një rritje të numrit të ankesave në periudhën 2021-2022.

### Ankesa të personave që vuajnë dënimin në IEVP



### Objektivi Specifik 3.1.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.1 parashikon 13 masa, prej të cilave 3 masa (masat 3.1.5, 3.1.6, dhe 3.1.12) fillojnë zbatueshmërinë në vitin 2024.

Nga 10 masat që kanë filluar zbatueshmërinë në periudhën 2021-2022, **8 janë zbatuar plotësisht** dhe **2 janë zbatuar pjesërisht** (80% e masave janë zbatuar plotësisht - niveli i tolerancës “mirë”). Niveli i realizimit të OS 3.1. sipas mesatares së përqindjes së zbatimit të masave është 92%.

**OS 3.1: Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë përditësuar duke synuar një qasje të integruar të institucioneve të drejtësisë dhe një qasje restauruese të drejtësisë, ndërtuar mbi parandalimin, risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin duke zëvendësuar qasjen ndëshkuese ekzistuese.**

3.1.1 *Kryerja e studimit të analizës për ndërhyrjet e mundshme në Kodin Penal.* (pz 2021-2025)

**Institucioni raportues:** Ministria e Drejtësisë

**Informacion mbi zbatimin e masës:**

Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, në vitin 2020 filloi puna për rishikimin e Kodit Penal aktual me synimin për hartimin e një Kodi të ri Penal.

Për të arritur këtë objektivi, grupi i ekspertëve kreu një studim të detajuar mbi nevojën e hartimit të Kodit Penal. Grupi i ekspertëve hartoi edhe metodologjinë për hartimin e Kodit të ri Penal. Puna përgatitore për Kodit të ri Penal është finalizuar nga MD.

3.1.2 *Përgatitja e një studimi të detajuar për praktikën më të mira evropiane, në funksion të ndryshimeve të KP-së, konsultimi me institucionet përkatëse për praktikën më të mirë për parandalimin e krimit dhe shpërndarja e analizës.* (pz 2021-2025)

**Institucioni raportues:** Ministria e Drejtësisë

**Informacion mbi zbatimin e masës:**

Një nga seksionet e analizës së hartuar nga grupi i ekspertëve të caktuar për përpunimin e Kodit të ri Penal është pikërisht nevoja për përafrimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, duke mbajtur veçanërisht në fokus praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ).

3.1.3	<p><i>Përgatitja e paketës së propozimeve për ndryshimet në Kodin Penal bazuar në gjetjet e analizës.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Gjatë procesit të hartimit të Kodit të ri Penal, janë ndërmarrë nisma ligjore për përmirësimin e Kodit Penal aktual në disa aspekte që lidhen me parandalimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Lidhur me këtë çështje është bërë një studim për harmonizimin e Kodit Penal me Kodin e Procedurës Penale.</p>
3.1.4	<p><i>Konsultimi i paketës së propozimeve me grupet e interesit (ëorkshop) dhe hartimi i raporteve të konsultimit / finalizimi i paketës dhe miratimi.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Drafti fillestar i Kodit të ri Penal ka qenë objekt konsultimi me të gjithë aktorët në fushën e drejtësisë qoftë në format elektronik, qoftë në zhvillimin e takimeve të përbashkëta me grupet e interesit.</p> <p>Duke qenë se drafti fillestar i Kodit të ri Penal u konsiderua jo përfundimtar pas përfundimit të këtyre takimeve konsultative, është e nevojshme që të vijojë procesi.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Procesi kërkon fillimin e rishikimit dhe ripunimit të draftit të parë të Kodit Penal me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë dhe kontributin e të gjithë aktorëve përkatës.</p>
3.1.5	<p><i>Kryerja e analizës dhe përgatitja e raporteve të monitorimit në lidhje me gjendjen e zbatueshmërisë së Kodit Penal, të ndryshuar.</i> (pz 2024-2024)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës</u></b></p> <p>Asnjë e dhënë.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>MD ende nuk ka dorëzuar propozimet për Kodin e Ri Penal në Kuvend.</p>
3.1.6	<p><i>Informimi dhe rritja e kapaciteteve të grupeve të interesit në lidhje me unifikimin e praktikës dhe zbatimin e Kodit të ri Penal (trajnime/seminare).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Asnjë e dhënë.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Si më sipër – masa 3.1.5.</p>
3.1.7	<p><i>Kryerja e studimit të status quo-së dhe analizës së ndërhyrjes për Kodin e Procedurës Penale (KPP).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Zbatuar në vitin 2021.</p>
3.1.8	<p><i>Përgatitja e një studimi të detajuar për praktikën më të mira evropiane, në funksion të ndryshimeve të KPrP, konsultimi me institucionet përkatëse për praktikën më të mirë për parandalimin e krimin</i></p>


	<p><i>dhe shpërndarja e analizës.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimimin e masës:</u></b> Zbatuar në vitin 2021.</p>
3.1.9	<p><i>Përgatitja e paketës së propozimeve për ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale bazuar në gjetjet e analizës.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimimin e masës:</u></b> Zbatuar në vitin 2021.</p>
3.1.10	<p><i>Konsultimi i paketës së propozimeve me grupet e interesit (ëorkshop) dhe hartimi i raporteve të konsultimit/finalizimi i paketës dhe miratimi.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Përmbledhja e veprimeve:</u></b> Zbatuar në vitin 2021.</p>
3.1.11	<p><i>Kryerja e analizës dhe përgatitja e raporteve të monitorimit në lidhje me zbatueshmërinë e Kodit të Procedurave Penale, të ndryshuar.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimimin e masës:</u></b> Kjo masë paraqitet si në zhvillim e sipër dhe në vijimësi për çdo rast, pasi zbatimi i Kodit të Procedurës Penale nuk bëhet nga Drejtoria e Kodifikimit, por nga gjykatat, prokuroritë dhe subjektet e tjera, të cilave u adresohen rregullat për procedimin penal dhe gjykimin, sipas rregullave të përcaktuara në Kod.</p>
3.1.12	<p><i>Informimi dhe rritja e kapaciteteve të grupeve të interesit në lidhje me unifikimin e praktikës dhe zbatimimin e Kodit të Procedurës Penale ( trajnime/seminare).</i> (pz 2024-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimimin e masës:</u></b> Nuk janë zbatuar. Masa fillon zbatueshmërinë në periudhën në vijim (2024-2025).</p> <p><b><u>Risqet dhe veprimet zbutëse:</u></b> Zbatimi varet nga miratimi i Kodit të ri Penal nga Kuvendi.</p>
3.1.13	<p><i>Ngritja dhe funksionimi i Grupit Tematik për Drejtësinë Penale.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimimin e masës:</u></b> Ngritja e Grupit Tematik në mbështetje të Komitetit Drejtues Sektorial për zbatimimin e “Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025”, Planit të Veprimit të saj dhe Pasaportës së Indikatorëve me Shkresën nr. 986 prot., datë 16.02.2022 dërguar me shkresë drejtuar institucioneve përkatëse.</p>

Për OS 3.1 është përcaktuar një tregues performance:

➤ **Shkalla e ndryshimeve në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale që reflektojnë standardet ndërkombëtare të drejtësisë penale**

Treguesi matet nëpërmjet një analize nga MD në lidhje me vlerësimin e ndryshimeve të Kodit Penal (KP) dhe Kodit të Procedurës Penale (KPrP).

Në vitin 2022, 50% e KP dhe 5% e KPrP janë të përfshirë në paketën e amendimeve që synojnë pasqyrimin e standardeve ndërkombëtare të drejtësisë penale. Faktorët që kanë ndikuar në proces përfshijnë kompleksitetin e kodeve, numrin e lartë të institucioneve të përfshira në zbatimin e tyre si dhe shkallën e përafrimit të legjislacionit vendas me aktet e BE-së.



**Pikat kryesore për OS 3.1.**

- Procesi për hartimin e Kodit të ri Penal është ende në vijim. MD ka krijuar një grup pune me përfaqësues të të gjitha palëve të interesuara, i cili është i ngarkuar me finalizimin e Kodit të Ri Penal. Afati për realizimin e këtij objekti është viti 2024.
- Procesi në vazhdim për hartimin e Kodit të ri Penal do të ketë kontributet nga të gjitha palët e interesuara dhe do të mbështetet nga projekte ndërkombëtare.
- Ndryshimet e KPrP-së janë miratuar tashmë nga Kuvendi dhe janë në proces zbatimi. Ende mungon një analizë për zbatimin e dispozitave të ndryshuara.

**Objektivi Specifik 3.2.**

Plani i Veprimit për Objektivin 3.2 parashikon 15 masa, prej të cilave 4 masa (masat 3.2.5, 3.2.6, 3.2.7 dhe 3.2.9) fillojnë zbatueshmërinë pas vitit 2022.

Nga 11 masat që kanë filluar zbatueshmërinë në periudhën 2021-2022, **7 masa janë zbatuar plotësisht** dhe **4 masa janë zbatuar pjesërisht** (64% e masave janë zbatuar plotësisht (niveli i tolerances “mirë”). Niveli i realizimit të OS 3.2. sipas mesatares së përqindjes së zbatimit të masave është 86%.

**OS 3.2: Një sistem prokurorie efikas dhe proaktiv që funksionon sipas standardeve evropiane me qëllim hetimin dhe ndjekjen efikase të korrupsionit dhe krimit të organizuar.**

3.2.1 *Përmirësimi i menaxhimit strukturor dhe administrimit të prokurorisë nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit eficient të burimeve njerëzore dhe buxhetit. (pz 2021-2025)*

**Institucioni raportues:** Prokuroria e Përgjithshme

**Informacion mbi zbatimin e masës:**

Gjatë gjithë vitit 2022, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë emëruar 21 oficerë të

	<p>policisë gjyqësore. Sipas përcaktimeve ligjore, këta oficerë kanë kryer trajnime profesionale përpara fillimit të detyrës. Gjithashtu, në bazë të nevojave të prokurorive, janë kryer ndërhyrje strukturore.</p>
3.2.2	<p><b><i>Kryerja e studimit të status quo-së dhe analizës së ndërhyrjes në ligjin organik të prokurorisë.</i></b> (pz 2021-2022)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Prokuroria e Përgjithshme</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Në prill të vitit 2022, PP ka përfunduar studimin dhe analizën për ndërhyrjen në ligjin organik të prokurorisë.</p>
3.2.3	<p><b><i>Përgatitja e paketës së propozimeve për ndryshimet në ligjin organik të prokurorisë bazuar në gjetjet e analizës.</i></b> (pz 2021-2022)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Prokuroria e Përgjithshme</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Përfaqësuesit e PP-së janë të përfshirë si anëtarë të Grupit të Punës të krijuar nga MD që punon për hartimin e kodit të ri penal.</p>
3.2.4	<p><b><i>Konsultimi i paketës së propozimeve me grupet e interesit (ëorkshop) dhe hartimi i raporteve të konsultimit/finalizimi i paketës dhe miratimi I ligjit organik të prokurorisë, të ndryshuar.</i></b> (pz 2021-2022)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Prokuroria e Përgjithshme</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Në shtator të vitit 2022, Komisioni i Ligjeve ftoi një përfaqësues të PP-së në Grupin e Punës ndërinstytucional dhe jo vetëm, ku në datën 4 tetor 2022, u zhvillua një seancë dëgjimore dhe pyetje me përfaqësuesin e PP-së në lidhje me propozimet për ndryshime në paketën ligjore.</p>
3.2.5	<p><b><i>Kryerja e analizës në lidhje me gjendjen e zbatueshmërisë së ligjit organik të prokurorisë, të ndryshuar.</i></b> (pz 2023-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Prokuroria e Përgjithshme</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Asnjë ndryshim.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b> Vendimi përfundimtar varet nga Kuvendi.</p>
3.2.6	<p><b><i>Kryerja e analizës në lidhje me nevojën për rishikim të akteve nënligjore, pas ndryshimeve në ligjin organik të prokurorisë.</i></b> (pz 2023-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Prokuroria e Përgjithshme</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Asnjë e dhënë.</p> <p><b><u>Risqet dhe veprimet zbutëse:</u></b> Si më sipër – 3.2.5.</p>
3.2.7	<p><b><i>Përgatitja, konsultimi dhe miratimi i paketës së akteve nënligjore të nevojshme.</i></b> (pz 2023-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Prokuroria e Përgjithshme</p>

	<p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Asnjë e dhënë.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Si më sipër 3.2.5.</p>
3.2.8	<p><i>Kryerja e analizës së nevojave për trajnim për rritjen e kapaciteteve të magistratëve prokurorë/OPGJ për kuadrin ligjor dhe nënligjor/ hartimi i moduleve të trajnimit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Në muajt prill-qershor 2022, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës ka analizuar dhe vlerësuar nevojat për forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, nëpërmjet kërkesës dhe interesit të përcjellë nga prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm për temat e propozuara për Programin e Formimit Vazhdues (PFV) të SHM për vitin akademik 2022-2023.</p>
3.2.9	<p><i>Informimi dhe rritja e kapaciteteve të grupeve të interesit në lidhje me ligjin organik të prokurorisë dhe aktet nënligjore (trajnime/seminare).</i> (pz 2023-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Shkolla e Magjistraturës ka organizuar një (1) trajnim për Prokurorinë mbi marrëdhëniet procedurale mes ndihmësprokurorit dhe drejtuesit të prokurorisë.</p>
3.2.10	<p><i>Përgatitja e analizave të rregullta ndërinstucionale mbi efikasitetin e hetimeve ndaj pastrimit të parave, hartimi i raporteve të analizës mbi evidentimin e problematikave dhe përgatitja e paketës së rekomandimeve.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Prokuroria e Përgjithshme</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Gjatë gjithë vitit 2022 janë zhvilluar takime pune dhe analiza në nivel qendror dhe vendor me institucionet e përfshira në planin e veprimit të ICRG/FATF për Shqipërinë (Drejtoria Kundër Pastrimit të Parave, Ministria e Financave, PP, institucionet bankare, etj.). PP nxorri 3 (tre) qarkore (prill/qershor/nëntor 2022) për intensifikimin e masave procedurale për bashkërendimin dhe koordinimin në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr.10/2020, si dhe për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve e ndjekjes penale kundër pastrimit të parave me institucionet e përfshira. Në PP dhe në prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm u zhvilluan takime me përfaqësues të DPPP-së, ku u diskutua për luftën kundër pastrimit të parave dhe masat e marra nga secili institucion.</p>
3.2.11	<p><i>Konsolidimi i burimeve njerëzore për funksionimin e plotë të SPAK-ut.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> SPAK</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Në strukturën e Prokurorisë Speciale për vitin 2022 janë parashikuar 111 punonjës nga të cilët 20 pozicione për prokurorë. Faktikisht janë punësuar 84 punonjës (17 prokurorë dhe 67 punonjës administrativë).</p> <p>Gjatë 6 muajve të parë të vitit 2022, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka emëruar 2 prokurorë dhe numri aktual i prokurorëve është gjithsej 17.</p>

	<p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Promovimi i kandidatëve prokurorë në SPAK nga KLP kërkon kohë pasi do të kryhen disa procedura të parashikuara në Rregulloren e KLP-së. Gjithashtu, numri i prokurorëve pranë Prokurorive të Rretheve është reduktuar për shkak të procesit të rivlerësimit që po vazhdon. Kështu, numri i çështjeve të prapambetura në prokurori është më i madh se sa mund të menaxhojnë prokurorët në detyrë.</p>
3.2.12	<p><b><i>Konsolidimi i burimeve njerëzore për funksionimin e plotë të BKH-së.</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> BKH</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Në muajin qershor 2022, hetuesit e nivelit të dytë të NBI-së u caktuan në detyrë duke plotësuar numrin total prej 60 hetuesish dhe u ndanë në dy seksione. Numri i punonjësve të miratuar në organizimin e BKH-së për vitin 2022 është 130 punonjës. Aktualisht janë emëruar vetëm 67 punonjës (Drejtor/hetues/kabinet/administratë) ose 51.5% e strukturës së miratuar. Aktualisht, hetuesit e BKH-së janë të angazhuar në hetimet e rreth 300 hetimeve procedurale.</p>
3.2.13	<p><b><i>Kryerja e analizës së nevojave për trajnim për rritjen e kapaciteteve të prokurorëve të SPAK-ut, hetuesve BKH-së, përgatitja e kurrikulave dhe moduleve të trajnimit</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> SPAK</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Prokurorët në SPAK, kanë kryer trajnime vazhduese pranë SHM-së sipas temave të përcaktuara në bazë të veprimtarisë së SPAK-ut. Po kështu, prokurorët janë trajnuar për tema specifike nga OJF ndërkombëtare.</p>
3.2.14	<p><b><i>Zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve institucionale të SPAK-ut (trajnime/seminare).</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> SPAK</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Administrata ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga DSIK dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.</p>
3.2.15	<p><b><i>Zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve institucionale të BKH-së (trajnime/seminare).</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> BKH</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Gjatë vitit 2022, 60 hetues të BKH-së kanë marrë pjesë në 36 trajnime, brenda dhe jashtë vendit.</p>


Për OS 3.2 është përcaktuar një tregues performance:

➤ **Përqindja e çështjeve që shkojnë në gjyq në të cilat i pandehuri është lënë i lirë.**

Në kuadrin e një sistemi të drejtësisë penale të mbështetur në parimet moderne evropiane, duke përfshirë edhe atë të pafajsisë, dhe që garanton respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, treguesi synon të masë raportin midis numrit të të pandehurve për të cilët është vendosur pafajësi ose pushim, dhe numrit total të të gjithë të pandehurve gjykuar nga gjykatat në vit.

Referuar kuptueshmëri të indikatorit dhe të dhënave të përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme mbi Prokuroritë, në përmbushje të detyrave të tyre funksionale, rezulton se në vitin 2021, për 1.66% të të pandehurve gjykuar në shkallë të parë, është dhënë një vendim pafajësie (8,371 të pandehur të dënuar dhe 144 të pandehur të shpallur të pafajshëm). Në vitin 2022, për 2.12% të të pandehurve gjykuar në shkallë të parë, është dhënë një vendim pafajësie ndërsa 97.92% e të pandehurve janë dënuar (9,447 të pandehur të dënuar dhe 205 të pandehur të shpallur të pafajshëm).

### Të pandehurit për të cilët është vendosur pafajësi



*Në përfundim, në workshopet e organizuara për hartimin e këtij Raporti, nga ana e përfaqësuesve të Prokurorisë konstatohet se ky tregues ka nevojë të rishikohet për të nxjerrë në pah punën e institucionit, për arsyen se nuk pasqyron zbatueshmërinë e masave të përcaktuara për OS 3.*

### Pikat kryesore për OS 3.2.

#### **Prokuroria e Përgjithshme.**

- Në vitin 2022 janë emëruar 21 oficerë të policisë gjyqësore në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Janë trajnuar 21 oficerë të policisë gjyqësore të sapoemëruar dhe 21 prokurorë të sapoemëruar.
- Prokuroria e Përgjithshme përfundoi në prill 2022 studimin e status quo-së dhe analizën e ndërhyrjes në ligjin organik të prokurorisë dhe paketa me propozimet i është dorëzuar Kuvendit të Shqipërisë.
- Gjatë gjithë vitit 2022, në trajnime të vazhdueshme kanë marrë pjesë 741 prokurorë dhe 84 oficerë të policisë gjyqësore.
- PP ka qenë mjaft aktive në lidhje me bashkëpunimin ndërinstitucional nëpërmjet organizimit të takimeve të përbashkëta, nënshkrimit të MM-ve, etj. Arritje të veçanta vërehen në vitin 2022 në lidhje me bashkëveprimin e PP-së dhe SHM-së.

#### **Byroja Kombëtare e Hetimit.**

- Në qershor të vitit 2022, BKH u kompletua plotësisht me numrin total prej 60 hetuesish. Janë emëruar vetëm 67 (nga 130 pozicione) punonjës ose 51.5% e strukturës së miratuar.
- Aktualisht, hetuesit e BKH-së janë të angazhuar në hetimin e rreth 300 hetimeve procedurale.
- Në vitin 2022, 60 hetues të BKH-së morën pjesë në 36 trajnime.

#### **SPAK**

- Funkcionaliteti i plotë i SPAK-ut është arritur pjesërisht. Në SPAK u ngritën në detyrë 17 prokurorë. Miratohen 20 pozicione prokurorësh në SPAK.
- Janë organizuar dhe zhvilluar trajnime speciale për prokurorët e SPAK-ut.



### Objektivi Specifik 3.4.<sup>14</sup>

Plani i Veprimit për Objektivin 3.4 parashikon 19 masa, prej të cilave 2 masa (masat 3.4.13, dhe 3.4.14) fillojnë zbatueshmërinë pas vitit 2022.

Nga 17 masat që kanë filluar zbatueshmërinë në periudhën 2021-2022, **9 masa janë zbatuar plotësisht**, **4 masa janë zbatuar pjesërisht**, dhe **4 masa rezultojnë të pazbatuara** (53% e masave janë zbatuar plotësisht (niveli i tolerances “mirë”). Niveli i realizimit të OS 3.4. sipas mesatares së përqindjes së zbatimit të masave është 66%.

**SO3.4: Një shërbim prove efektiv dhe efikas që përdor standardet operacionale, metodologjitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimin e individualizuar të çështjeve, mbështet risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin dhe punon në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira të BE-së.**

3.4.1	<p><i>Kryerja e analizës në lidhje me nivelin e zbatueshmërisë dhe nevojën për ndryshime të kuadrit ligjor në lidhje me DPSHP-në dhe strukturën organizative të saj për t'u përshatur me standardet evropiane (pz 2021-2021)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Është bërë një analizë në lidhje me nivelin e zbatueshmërisë dhe struktura e re i është përcjellë për miratim institucioneve përkatëse.</p>
3.4.2	<p><i>Përgatitja e paketës së ndërhyrjeve ligjore në kuadrin nënligjor të DPSHP-së, konsultimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve ligjore e nënligjore. (pz 2022-2022)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Aktet e miratuara në zbatim të ligjit nr. 78/2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- 6 akte të miratuara në vitin 2020 dhe në vitin 2021</li><li>- 2 Urdhra të Ministrit të Drejtësisë të nxjerra në vitin 2022.</li></ul>
3.4.3	<p><i>Kryerja e analizës së nevojave për trajnim të burimeve njerëzore pranë DPSHP-së dhe përgatitja e planit të trajnimit / kurrikulave dhe programeve të trajnimit (trajnimi bazë dhe vazhdues). (pz 2021-2021)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Mbështetur në analizën e nevojave për trajnim të stafit në DPSHP, Ministri i Drejtësisë nxori Urdhrin nr. 80, datë 22.02.2022 “Për miratimin e Formimit Fillestar dhe Vazhdues të Specialistëve të Shërbimit të Provës”.</p>
3.4.4	<p><i>Trajnimi i nëpunësve të DPSHP-së për rritjen e performancës në kryerjen e funksioneve (trajnim bazë dhe vazhdues). (pz 2021-2023)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur disa trajnime dhe janë trajnuar më shumë se 60 punonjës të</p>

<sup>14</sup> Objektivi 3.3 nuk është përfshirë në planin e veprimit të SND 2021-2025 për të shmangur mbivendosjen me masat e parashikuara në Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur.

	DPSHP-së. Objektivat e trajnimeve mund të shikohen në Planin e Veprimit.
3.4.5	<p><i>Konsolidimi dhe finalizimi i marrëveshjeve të binjakëzimit/bashkëpunimit me partnerët institucionalë evropianë.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Anëtarësimi në Konfederatën Evropiane të Shërbimit të Provës dhe pjesëmarrja në studime të kryera nga Universitete ndërkombëtare në fushën e Shërbimit të Provës.</p>
3.4.6	<p><i>Kryerja e analizës së funksionimit të sistemit të administrimit të çështjeve dhe përgatitja e rekomandimeve për përmirësimin.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> U hartua Rregullorja për administrimin dhe përcaktimin e roleve që kanë të drejta akses në bazën e të dhënave të personave nën mbikëqyrje në sistemin e Shërbimit të Provës me Urdhrin nr. 27 të Drejtorit të Përgjithshëm, datë 18.03.2022.</p>
3.4.7	<p><i>Dizenjimi dhe instalimi i teknologjisë së informacionit bashkëkohor si dhe sistemit të administrimit të çështjeve, duke krijuar lidhje me sistemin e integruar të drejtësisë elektronike.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Shërbimi i Provës është një nga hallkat e zinxhirit të institucioneve në fushën e drejtësisë penale dhe realizimi i kësaj mase varet nga aktorë të tjerë.</p>
3.4.8	<p><i>Përmirësimi i infrastrukturës dhe pajisjeve për funksionimin e plotë të zyrave rajonale të DPSHP-së në përputhje me standardet evropiane.</i> (pz 2022-2022)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Si pasojë e vendeve të lira të punës, raporti i dosjeve për specialist është shumë më i lartë se standardet evropiane, pajisjet në të gjitha degët territoriale janë funksionale, por edhe mungesa e hapësirave të dedikuara për trajtimin e të miturve është një problem që e bën këtë masë të realizohet pjesërisht. .</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b> Mungesa e hapësirave të dedikuara për trajtimin e të miturve në shumicën e degëve territoriale është cilësuar si problem nga DPSHP-ja.</p>
3.4.9	<p><i>Kryerja e analizës mbi rishikimin e akteve nenligjore specifike, rregulloreve, udhëzimeve, standardeve përfshirë afatet kohore dhe formatet për punën para dënimit.</i> (pz 2022-2022)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b> Asnjë e dhënë.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b> Kjo masë do të analizohet dhe rishikohet gjatë shqyrtimit dhe azhornimit të ardhshëm të SND.</p>
3.4.10	<p><i>Hartimi i paketës së akteve nenligjore specifike, rregulloreve, udhëzimeve, standardeve/ konsultimi i paketës dhe miratimi.</i> (pz 2021-2021)</p>


	<p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Me vendim nr.421 të Këshillit të Ministrave, datë 08.07.2021 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të Shërbimit të Provës” është miratuar rregullorja e përgjithshme, 6 akte të tjera nënligjore janë miratuar në vitin 2020 dhe në vitin 2021. Në vitin 2022 u lëshuan 2 urdhra nga Ministri i Drejtësisë në lidhje me DPSHP-në.</p>
3.4.11	<p><i>Hartimi i metodologjive (udhëzime, standarde) të reja lidhur me (i) mbikëqyrjen (menaxhimi i çështjeve individuale dhe mbikëqyrja elektronike); (ii) lirin me kusht. (pz 2022-2022)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Janë miratuar aktet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▫ Udhëzimi nr. 1 i Drejtorit të Përgjithshëm, datë 04.10.2022, për hartimin e raporteve të vlerësimit për personat nën mbikëqyrje në rast të plotësimit të dënimit alternativ.</li> <li>▫ Urdhri nr. 367 i Ministrit të Drejtësisë, datë 22.07.2022 “Për përcaktimin e një mekanizmi përforcues monitorues në lidhje me hartimin e raporteve të vlerësimit të IEVP-së dhe DPSHP-së për të dënuarit me dënim mbi 15 vjet burgim”.</li> </ul>
3.4.12	<p><i>Përgatitja e programeve të pilotimit të metodologjive të reja të mbikëqyrjes dhe pilotimi i tyre në dy zona. (pz 2022-2023)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Nuk janë zbatuar.</p>
3.4.13	<p><i>Kryerja e analizës në lidhje me vlerësimin e përvojës së përdorimit të metodologjive të reja të mbikëqyrjes në zonat pilot dhe përgatitja e programit kombëtar të mbikëqyrjes elektronike dhe lirit me kusht. (pz 2024-2024)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Nuk janë zbatuar, do të vijojë në vitet në vijim.</p>
3.4.14	<p><i>Konsolidimi i metodologjive të mbikëqyrjes e protokolleve dhe funksionimi i tyre në të gjithë territorin. (pz 2024-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Nuk janë zbatuar, do të vijojë në vitet në vijim.</p>
3.4.15	<p><i>Kryerja e analizës në lidhje me nevojën për bashkëpunim të DPSHP-së me institucionet përkatëse të drejtësisë dhe hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit për punën në shërbimin e provës në fazën para dënimit. (pz 2021-2021)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Në përmbushje të misionit të Shërbimit të Provës, për rehabilitimin dhe riintegrimin e personave nën mbikëqyrje (pas dënimit), por edhe për zbatimin e dënimeve alternative nga gjykatat (para dënimit), SHP ka hartuar dhe zbatuar që nga viti 2022 e në vazhdim planin vjetor të aktiviteteve, në kuadër të të cilit zhvillohen takime me institucionet për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me</p>

	<p>qëllim riintegrimin e personave nën mbikëqyrje ose që kryejnë punë në interes publik, si dhe takime me gjyqtarë dhe prokurorë të gjykatave të rrethit gjyqësor me synim nxitjen e aplikimit të dënimeve alternative/masave alternative dhe diskutimin e problematikave të hasura në lidhje me zbatimin e dënimeve/masave alternative.</p>
3.4.16	<p><i>Forcimi i bashkëpunimit me institucionet përkatëse të drejtësisë (gjykatat, prokuroria, sistemi penitenciar) për punën e shërbimit të provës (trajnime/ëorkshop-e).</i> (pz 2022-2024)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Shërbimi i Provës gjatë viteve 2022 dhe 2023 ka rënë dakord me Shkollën e Magjistraturës për zhvillimin e trajnimeve për temat që u vinin në ndihmë punonjësve të Shërbimit të Provës dhe në vitin 2022, SHM zhvilloi trajnime me temën “Lirim me kusht”: plotësimi i kushteve të lejes, kriteret ligjore; dënimi i përjetshëm dhe llogaritja e kohës së kryer të dënimit; periudha e sigurisë dhe lirimi me kusht; recidivizmi, sjellja e të dënuarve në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe marrëdhënia shkelës-viktimit si elemente thelbësore të raportit të vlerësimit të shërbimit të provës.</p>
3.4.17	<p><i>Përgatitja e një programi të përbashkët komunikimi me popullatën e gjerë.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>U miratua programi dhe u ndoq plani vjetor i veprimit për vitin 2022 dhe për vitin 2023.</p>
3.4.18	<p><i>Përgatitja e programeve të bashkëpunimit me KLGJ-në, KLP-në, PP-në, SHM-në për të informuar për qasjet e reja dhe mundësitë e një shërbimi modern prove sipas standardeve europiane.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Nuk janë zbatuar.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b></p> <p>Duhet të sigurohet vullneti i të gjitha institucioneve.</p>
3.4.19	<p><i>Rritja e kapacitetit të stafit për të siguruar një normë prej 50 stazhierësh për staf në përputhje me standartet evropiane dhe për të siguruar stafin e duhur për zyrat vendore, si dhe struktura e pagave u rishikua për të siguruar pagesën e duhur në të gjithë organizatën sipas aftësive dhe përgjegjësi në përputhje me skemën zyrtare të pagave.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Struktura e institucionit është 147 punonjës, me ndryshimet e reja shkon në 167 punonjës. Në përgjithësi, shërbimi i provës ka miratuar planin për zhvillimin e praktikave mësimore pranë degëve territoriale të shërbimit të provës.</p>

Për OS 3.4 janë përcaktuar dy tregues performance:

- **% e numrit të vendimeve penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet, të cilat përfshijnë dënime alternative.**

Vlera e synuar për vitin 2022 për këtë tregues performance është 66%. Është raportuar se në periudhën janar-dhjetor 2022, 6,688 vendime penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet kanë përfshirë dënime alternative. Këto përbëjnë 63.4% të çështjeve. Targeti është arritur pjesërisht.



- **Raporti i personave nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës të liruar me kusht (ose forma të tjera të lirimit me kusht), të cilët kanë shërbyer me sukses në shërbimin e provës.**

Ky tregues është i rëndësishëm për matjen e cilësisë së punës së Shërbimit të Provës. Vlera e synuar për vitin 2022 për këtë tregues performance është 99%. Të dhënat e raportuara nga Shërbimi i Provës, tregojnë se 100% e të paraburgosurve nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës që janë liruar me kusht (ose forma të tjera lirimi me kusht), kanë shërbyer me sukses në shërbimin e provës.



#### **Pikat kryesore për OS 3.4.**

##### **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**

- Është bërë një analizë për nivelin e zbatueshmërisë dhe nevojën për ndryshime në kuadrin ligjor në lidhje me Drejtorinë e Përgjithshme të Provës.
- Trajnimet e punonjësve të DPSHP-së u zhvilluan me qëllim rritjen e performancës gjatë kryerjes së funksioneve përkatëse (trajnime bazë dhe vazhduese).
- Anëtarësimi në Konfederatën Evropiane të Shërbimit të Provës dhe pjesëmarrja në studimet e kryera nga universitetet ndërkombëtare në fushën e provës.
- U hartuan metodologji të reja lidhur me (i) mbikëqyrjen (menaxhimi i rasteve individuale dhe mbikëqyrja elektronike); (ii) lirimimin me kusht.
- Udhëzimi nr. 1 i Drejtorit të Përgjithshëm, datë 04.10.2022, për hartimin e raporteve të vlerësimit për personat nën mbikëqyrje në rastin e përfundimit të dënimit alternativ. Urdhri nr. 367 i Ministrit të Drejtësisë, datë 22.07.2022 “Për përcaktimin e një mekanizmi

përforcues monitorues në lidhje me hartimin e raporteve të vlerësimit të IEVP-ve dhe DPSHP-së për të dënuarit me mbi 15 vjet burgim”.

### Objektivi Specifik 3.5

Plani i Veprimit për Objektivin 3.5 parashikon 17 masa, prej të cilave 2 masa (masat 3.5.3, dhe 3.5.5) fillojnë zbatueshmërinë pas vitit 2022.

Nga 15 masat që kanë filluar zbatueshmërinë në periudhën 2021-2022, **5 masa janë zbatuar plotësisht** dhe **10 masa rezultojnë të zbatuara pjesërisht** (33% e masave janë zbatuar plotësisht - niveli i tolerances “mjaftueshëm”. Niveli i realizimit të OS 3.5. sipas përqindjes së zbatimit të masave është 83%.

<b>OS 3.5: Zhvillimi i sistemit penitenciar bazuar në standardet evropiane, që siguron respekt të plotë për burimet njerëzore dhe përdor plane zhvillimi individualë</b>	
3.5.1	<p><i>Kryerja e analizës në lidhje me nevojën për hartimin e legjislacionit/ akteve nënligjore/ rregulloreve sipas ndryshimeve të paketës legjislativë penitenciare.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><b>Institucioni raportues:</b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b>Informacion mbi zbatimin e masës:</b> Zbatuar në vitin 2021.</p>
3.5.2	<p><i>Hartimi/konsultimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe rregulloreve specifike (Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve/ Kodi i Etikës/Shërbimi i Sigurimit/policia e burgjeve/punësimi i të burgosurve) ( 3 konsultime).</i> (pz 2021-2021)</p> <p><b>Institucioni raportues:</b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b>Informacion mbi zbatimin e masës:</b> Ka përfunduar hartimi/konsultimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe rregulloreve specifike (Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve/Kodi i Etikës/Shërbimi i Sigurimit/Policia e Burgjeve/Punësimi i të Burgosurve).</p>
3.5.3	<p><i>Përgatitja, konsultimi dhe miratimi i paketës ligjore për kriteret e përzgjedhjes, autorizimin, llogaridhënia dhe detyrimi i drejtuesve të burgjeve dhe menaxherëve të lartë mbështetur në rekomandimet e KE.</i> (pz 2023-2023)</p> <p><b>Institucioni raportues:</b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b>Informacion mbi zbatimin e masës:</b> Lidhur me këtë masë është hartuar drafti për ndryshimet në ligjin 81/2020, të cilat kanë të bëjnë me statusin e punonjësve të DPB-së ku parashikohet dalja nga statusi i nëpunësit civil sipas ligjit 152/2013. Pas miratimit të këtij ndryshimi, do të parashikohen kriteret specifike të përditësuara për drejtuesit e IEVP-ve.</p>
3.5.4	<p><i>Hartimi dhe miratimi i skemës dhe standardeve për (i) mbikëqyrjen e rregullt psikologjike për të gjithë stafin (ii) vlerësimin e performancës për IEVP dhe pilotimi i skemave në 4 IEVP.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><b>Institucioni raportues:</b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b>Informacion mbi zbatimin e masës:</b> Lidhur me këtë masë, DPB-ja në bashkëpunim me KE-në në zbatimin e fazës së tretë 2023-2027, të</p>

	<p>projektit <i>Horizontal Facility 2</i>, e ka parashikuar si masë strategjike në kuadër të mirëqenies dhe kujdesit të stafit.</p> <p><b><u>Risqet dhe hapat në vijim:</u></b> Angazhimi i DPB-së me projekte të tjera më urgjente ka sjellë shtyrjen e zbatimit të kësaj mase. Afati i implemtimit të masës ka përfunduar por duke marrë në konsideratë rëndësinë e saj është e rëndësishme të ndërmerren hapa për të vijuar implementimin e plotë në periudhën në vijim. <i>Vlen të theksohet se sa lidhte me masat e zbatuara pjesërisht, ato vijnë në proces dhe tashme janë zbardhur në plane konkrete veprimi për t'u adresuar në vijim.</i></p>
3.5.5	<p><b><i>Trajnime të nëpunësve të burgjeve në lidhje me paketën ligjore/nënligjore të miratuar/ skemat dhe standardet e miratuara.</i></b> (pz 2024-2024)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p><b><u>Përmbledhja e veprimeve:</u></b></p> <p>Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 janë trajnuar 1774 punonjës (44% e numrit të përgjithshëm), nga të cilët 1161 janë punonjës me rol bazë, 233 punonjës të nivelit të mesëm, 350 punonjës të nivelit të mesëm të shërbimeve multidisiplinore; 30 janë punonjës të nivelit drejtues.</p> <p>Rregullorja e Personelit të Policisë së Burgjeve është miratuar me VKM nr. 43, datë 09.06.2022, nëpërmjet të cilit përcaktohen rregulla të detajuara për trajnimin dhe ecurinë në karrierë të punonjësve të Policisë së Burgjeve.</p> <p>Qendra e trajnimit u krijua.</p> <p>Është hera e parë pas 21 vitesh që nga krijimi i Qendrës së Trajnimit, ku numri i stafit trajnues është trefishuar.</p> <p>Me mbështetjen e KE-së dhe Ambasadës Amerikane janë zhvilluar disa trajnime në vitin 2022.</p>
3.5.6	<p><b><i>Përgatitja e një raporti analitik për kushtet e punës në burgje/ identifikimi i problemeve dhe nevojave për përmirësim dhe hartimi i një plani operacional masash në zbatim të gjetjeve të raportit analitik.</i></b> (pz 2022-2024)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Ky raport është hartuar nga ekspertët e KE-së, në kuadër të projekteve <i>Horizontal Facility2 (faza e dytë)</i> në vitin 2022. Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të parashikuara në ligj janë miratuar gjatë vitit 2022.</p>
3.5.7	<p><b><i>Përgatitja e moduleve të programeve për parandalimin e recedivizmit (i) për kriminelët seksualë dhe kriminelët e dhunshëm (ii) për personat e varur nga droga,alkooli dhe pilotimi në 8 IEVP.</i></b> (pz 2021-2021)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>DPB-ja është në fazën përfundimtare të finalizimit të programit “Aftësi për jetën”, i cili do të adresojë nevojat e të burgosurve për rehabilitimin e tyre holistik dhe riintegrimin e mëtejshëm në shoqëri. Gjatë vitit 2021 janë miratuar 2 manuale të rëndësishme për stafin e kujdesit psiko-social në IEVP, për punën rehabilituese me personat me probleme abuzimi/varësia nga substancat, të rinjtë e grupmoshës 18-21 vjeç, personat me probleme të shëndetit mendor. Është kryer vlerësimi i riskut dhe i nevojave. DPB i zbaton këto instrumente. KE ofron mbështetje për DPB-në për aplikimin e një qasjeje të strukturuar për qytetarët që kanë kryer krime seksuale dhe të dhunshme. Masa ka përfunduar periudhën e sj të zbatimit, por do të ndërmerren masa për të vijuar realizimin e plotë të saj,</p>
3.5.8	<p><b><i>Trajnimi i stafit në lidhje me programet për parandalimin e recedivizmit.</i></b> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p>

	<p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Stafi multidisiplinor është trajnuar në lidhje me programet psiko-edukative për parandalimin e recidivizmit, si dhe metodologjitë relevante që fuqizojnë stafet në këtë kuadër si psh. intervistimi motivues, etj. Fokus te veçante kane patur programet për te rinjte 18-21 vjec, ish përdorues të lëndëve narkotike, puna mbi parandalimin e radikalizmit, menaxhimin e ekstremistëve të dhunshëm etj. Është një proces i vazhdueshëm.</p>
3.5.9	<p><i>Dizanjimi dhe konsolidimi i koncept dokumentit për Strategjinë për përmirësimin e funksionimit të sistemit të burgjeve (plani i masave për arsimimi i të burgosurve/shërbime sociale / planifikimi paralirimi / mbështetje pas lirit). (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Është në proces miratimi i marrëveshjes ndërinstytucionale që do të ofrojë infrastrukturën e duhur për rritjen e numrit të I EVP-ve ku do të zbatohet arsimiti dhe aftësimi profesional. KE-ja mbështet DPB-në në këtë drejtim.</p>
3.5.10	<p><i>Konsultimi/ finalizimi dhe miratimi i planit të veprimit strategjik dhe prezantimi në një tavoline të rrumbullakët. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Me urdhër nr. 6111 prot., datë 23.11.2021 të Ministrisë së Drejtësisë dhe nr. 4787 prot., datë 23.11.2021 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është lidhur Marrëveshja e Përbashkët e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit përgjegjës për Shëndetësinë për “Trajtimin e shtetasve me masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe shtrim i përkohshëm”. Gjithashtu, me urdhër të përbashkët nr. 55, datë 26.01.2022, ndërmjet MD-së dhe MSHMS-së, u krijua grupi i punës “Për ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës për monitorimin e zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit “Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, me masa mjekësore” dhe u ra dakord për planin e përbashkët të veprimit për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin me masa mjekësore të personave me çrregullime të shëndetit mendor.</p>
3.5.11	<p><i>Hartimi, Konsolidimi dhe finalizimi i memorandumit të bashkëpunimit me MSHMS për kujdesin dhe trajtimin e shkelësve të papërgjegjshëm dhe në kujdesin e pacientëve të dënuar me probleme mendore dhe të atyre në paraburgim dhe memorandum me institucionet e tjera. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Zbatimi i planit të veprimit po ndiqet me urdhër të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve bazuar në këtë plan veprimi, ka kryer me sukses detyrat e saj në kuadër të transferimit të këtyre shtetasve nga I EVP Krujë në I EVP Lezhë, ku aty i trajton me qasje multidisiplinare, bazuar në standardet në këtë kuadër.</p>
3.5.12	<p><i>Hartimi, konsultimi dhe miratimi i protokollit për funksionimin e njësive të kujdesit të veçantë në burgje, për sigurimin e një mjedisi më të përshtatshëm dhe përgatitjen e udhëzimeve të nevojshme për zbatimin e tij. (pz 2021-2025)</i></p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>SKV-të janë krijuar në I EVP Durrës, Fier, Malësi e Madhe Reç, Peqin, Rrogzhinë, Ali Demi, Jordan Misja, Lezhë, Elbasan.</p>



	<p>DPB ka zhvilluar analiza të detajuara dhe verifikime në vend në çdo I EVP për këtë grup të synuar. Vlerësimi për nevojat e ndihmës shtesë shëndetësore është bërë duke i transferuar ato në SKV të I EVP-ve që kanë një mjek psikiatër. KE-ja e mbështet këtë aktivitet.</p>
3.5.13	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të kuadrit legjislativ, menaxhimit të çështjeve dhe kapaciteteve institucionale për të identifikuar fushat e riskut dhe për të kuptuar dobësitë e sistemit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>DPB-ja ka ndërmarrë nismën e ristrukturimit dhe rialokimit të asetëve njerëzore profesionale. Drejtoria është në proces akomodimi të strukturës së re organike, Plani i Integritetit 2022-2024 vazhdon të monitorohet.</p>
3.5.14	<p><i>Identifikimi i mjetit të vlerësimit të riskut për tu miratuar në sistemin e burgjeve në Shqipëri dhe pilotimi në 4 I EVP.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>DPB-ja, në bashkëpunim të ngushtë me KE-në, është angazhuar në zbatimin e projektit pilot në lidhje me hartimin dhe zbatimin e dokumentit të nevojave dhe vlerësimit të riskut. Pilotimi është shtrirë në tre I EVP: “Ali Demi”, Fier dhe Peqin.</p>
3.5.15	<p><i>Konsolidimi dhe finalizimi i dokumentit operacional të brendshëm për procedurat që do të ndiqen në lidhje me regjimet e brendshme, trajtimi individual, programet e disponueshme ose programet që duhet të zhvillohen në kohën kur këta të burgosur do të dërgohen në institucionin e vuajtjes së dënimit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Veprimet operative janë finalizuar me instrumentet përkatëse. E vetmja gjë e nevojshme për të bërë është integrimi i tyre në një dokument të vetëm për të lehtësuar aktivitetin në institucion.</p>
3.5.16	<p><i>Trajnime të nëpunësve të sistemit të burgjeve për të rritur performancën e tyre në sistem lidhur me (i) Funksionimi e njësisë të kujdesit të posaçëm në rrugë(ii) analizën / vlerësimin e rriskut (iii) kuadrit ligjor/nënligjor në fuqi.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>Trajnime për stafin multidisiplinor të I EVP-ve për menaxhimin dhe trajtimin e të dënuarve me probleme të shëndetit mendor, të mundësuar nga KE, CPT, KSHH, Shoqata Stop AIDS dhe Aksion Plus. Po ndjekin procesin e miratimit të protokolleve dhe procedurave standarte operacionale në këtë kuadër, në bashkëpunim me KE-në.</p>
3.5.17	<p><i>Konsolidimi dhe përmirësimi i mekanizmave ndërinstitutional për adresimin e Shkelësve Ekstremist të Dhunshëm ( 1-7 mbledhje koordinimi).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><b><u>Institucioni raportues:</u></b> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><b><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></b></p> <p>KE po mbështet sistemin shqiptar të burgjeve me ekspertizë për hartimin e një metodologjie vlerësimi, menaxhimi dhe ndërhyrjeje për të burgosurit dhe ata të dënuar për vepra terroriste Gjatë vitit 2022, KE ka ofruar mbështetje për organizimin e trajnimit të trajnuesve nëpërmjet një sesi 4-ditor për 10-15 punonjës burgjesh; pilotimin e instrumenteve dhe programit në 3 I EVP, si dhe vlerësimin e rezultateve.</p>

Për OS 3.5 është përcaktuar një tregues performance:

➤ **Raporti i personave me numrin e shtretërve, p.sh. si masë e mbipopullimit të burgjeve.**

Në kuadrin e zhvillimit të një sistemi penitenciar bazuar në standardet evropiane, që siguron respekt të plotë lidhur me të drejtat e njeriut dhe përdor plane zhvillimi individuale, treguesi mat nivelin e mbipopullimit në burgje duke synuar uljen e graduale të vlerës të raportit midis numrit të personave që vuajnë dënimin pranë IEVP dhe numrit të shtretërve, e cila në çdo rast duhet të jetë nën 100% (tregues me trend zbritës).

Vlera e synuar për këtë tregues performance në vitin 2022 është 85%, e cila kërkon që 15% e shtretërve të jenë të lirë. DPB ka raportuar një raport prej 89%, dmth vetëm 11% e shtretërve të lirë. Rezulton se targeti nuk është realizuar plotësisht.



Ndonëse në nivel të përgjithshëm sistemi i burgjeve ka qenë në nivel nënpopullimi (11% vende të lira në 2022, dhe 14% në 2021), në disa institucione ka pasur nivel të vazhdueshëm mbipopullimi për shkak të specifikave të tyre. Duhet pasur parasysh se ky tregues ndryshon vazhdimisht dhe është i lidhur ngushtë me hyrjet e reja në institucione dhe infrastrukturën aktuale të sistemit. Stafi i dedikuar menaxhon në mënyrë të vazhdueshme çështjen e mbipopullimit nëpërmjet masave organizative dhe proceseve të transferimit.

Përveç këtyre, eliminimi i mbipopullimit në burgje ka ardhur edhe si rezultat i kryerjes rast pas rasti të një studimi të kujdesshëm të shpërndarjes dhe akomodimit të të burgosurve në IEVP. Studime të tilla kanë marrë parasysh faktorë si: e drejta e një të paraburgosuri për t'u vendosur në një qendër paraburgimi sa më afër vendbanimit të tij; nevojat e zbatimit të procedurave të hetimit penal me koston më të ulët (kohë dhe shpenzime), si dhe minimizimin e risqeve të sigurisë; si dhe kapacitetin dhe përqindjen e popullsisë në qendrat më të afërta të paraburgimit.

### **Pikat kryesore për OS 3.5.**

#### **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**

